



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Nënkomisioni për Barazi Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.02.2020, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Eglantina Gjermeni – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Funksionimi i mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare në nivel vendor në Republikën e Shqipërisë.

Marrin pjesë:

Eglantina Gjermeni, Arlind Çaçani, Klodiana Spahiu, Antoneta Dhima, Ediola Braha dhe Milva Ekonomi

Mungojnë:

Elona Gjebrea, Musa Ulqini, Rudina Hajdari, Amra Borova, Enada Kapllani, Almira Xhembulla dhe Fatjona Dhimitri

Të ftuar:

Merita Xhafaj – Drejtoreshë e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale

Iris Aliaj – Këshilltare në Ministrinë e Drejtësisë

Romina Kuko – Zëvendësministre e Ministrisë së Punëve të Brendshme

Adelina Farrici – Përfaqësuese nga Shoqata për Autonominë Vendore

Agron Haxhimali - Përfaqësues nga Shoqata e Bashkive

Aurela Bozo - Përfaqësuese nga Qendra për Nismën Ligjore dhe Qytetare

Ines Leskaj - Përfaqësuese nga AWEN

Altin Hazizaj - Përfaqësues nga CRCA

Edlira Papavangjeli - Përfaqësuese nga UNDP-ja

Entela Lako- përfaqësuese nga UNDP

Esmeralda Hoxha- përfaqësues nga GACD-ja

Mirela Arqimandriti - përfaqësuese nga GADC

Elsana Agolli - përfaqësues nga UNFPA

Iris Luarasi- përfaqësuese nga Linja se Këshillimit për Gra/Burra

Enxhi Pepa - përfaqësuese nga Linja se Këshillimit për Gra/Burra

Michele Ribotta - përfaqësuese nga UN Women

Alba Agolli - përfaqësuese nga UN Women

HAPET MBLEDHJA

Eglantina Gjermeni – Përshëndetje të gjithëve!

Faleminderit për prezencën tuaj sot në komision.

Kjo seancë dëgjimore është organizuar nga parlamenti i Shqipërisë, në mënyrë specifike nga Nënkomisioni për Barazi Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas, nga Nënkomisioni për Çështjet Vendore dhe nga Aleanca e Grave Deputete, për të diskutuar së bashku problematikat që ka mekanizmi i referimit për viktimat e dhunës në familje, shqetësimet, efikasitetin e tyre, dhe në mënyrë specifike, cilat janë rekomandimet apo sugjerimet e institucioneve shtetërore, të organizatave të shoqërisë civile për mënyrën e funksionimit të këtyre mekanizmave, për të parandaluar dhe për të trajtuar rastet e dhunës ndaj gruas dhe dhunës në familje.

Sigurisht, dhuna në familje është një problem që na prek të gjithëve. Për shoqërinë shqiptare, por jo vetëm, është vërtet një problem shumë shqetësues.

Unë dua t'i vlerësoj të gjitha përmirësimet ligjore që janë bërë për të parandaluar dhe trajtuar këtë problem kaq të mprehtë të shoqërisë shqiptare, por kemi vënë re se, për shkak të disa faktorëve, si socialë, kulturorë, ekonomikë, historikë rastet e dhunës në familje janë rritur. Pavarësisht përgjigjes apo reagimit të institucioneve, sërish vëmë re mungesë efikasiteti apo problematika që jo radhë janë edhe në medie dhe janë shqetësime për publikun.

Pikërisht për këtë nënkomisioni mori nismën për të diskutuar së bashku.

Ju falënderoj sërish që jeni pjesë e kësaj dëgjese, por theksoj se nuk është hera e parë që diskutohet në parlament kjo problematikë. Po ashtu, kemi organizuar edhe seanca dëgjimore.

Sot do të doja të ishim sa më konkretë, sa më efikas, duke diskutuar të gjithë, duke filluar me institucionet publike, me aktorët e shoqërisë civile dhe me shoqatat e pushtetit vendor për të parë se cilat hallka të këtij mekanizmi nuk funksionojnë dhe cilat janë rekomandimet apo sugjerimet konkrete, që duhet të bëjmë, për të përmirësuar punën dhe për të adresuar këtë problem kaq të mprehtë.

Nga Ministria e Shëndetësisë, Punëve dhe Çështjeve Sociale kemi të ftuar zonjën Merita Xhafaj, drejtoreshë e Përgjithshme e Politikave, Zhvillimit të Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale.

Mirë se erdhët, zonjë!

Nga Ministria e Drejtësisë kemi zonjën Irisa Aliaj, këshilltare.

Faleminderit dhe mirë se erdhët!

Nga Ministria e Punëve të Brendshme kemi të ftuar zonjën zëvendësministre, Romina Kuka.

Faleminderit!

Kemi prezent përfaqësues të shoqatave të bashkive në Republikën e Shqipërisë, zonjën Adelina Fariçi nga Shoqata për Autonominë Vendore, zotin Agron Haxhimihali nga Shoqata e Bashkive, zonjën Mirela Arqimandriti nga shoqëria civile, Aleanca Gjinore për Zhvillim, zonjën Aurela Bozo, Qendra për Nismën Ligjore Qytetare, zonjën Ines Leskaj, zoti Aktin Hazizaj nga CRCA-ja mungojnë zonja Edlira Papavangjeli dhe Entela Lako nga UNDP-ja, zonja Esmeralda Hoxha nga GACD-ja, zonja Elsiana Agolli nga UNFPA-ja, zonjat Iris Luarasi dhe Enxhi Pepa nga Linja e Këshillimit për Gratë dhe Burrat, Mikel Heribota dhe Alba Agolli nga UN Women.

Faleminderit për prezencën!

Kemi tri grupime brenda parlamentit, që e organizojnë këtë seancë dëgjimore. Unë doja t'i ftoj të gjithë deputetët që janë të interesuar. Kërkoj ndjesë për disa prej tyre, që, pavarësisht konfirmimit dhe dëshirës, kanë njëkohësisht edhe komisione të tjera parlamentare dhe nuk mund të jenë prezent.

Pa dyshim, para se t'i jepja fjalën të ftuarve, do të falënderoj zotin Fino, kryetarin e Nënkomisionit të Çështjeve Vendore, që ka qenë vërtet shumë i angazhuar që në krye të herës. Së bashku i kemi drejtuar letra të gjitha bashkive, jemi munduar të monitorojmë punën e tyre për sa i përket ngritjes së mekanizmit të referimit për viktimat e dhunës dhe jemi sërish bashkë për ta monitoruar këtë çështje dhe për të adresuar më tej problematikat që dalin.

E falënderoj kontributin e secilës zonjë përfaqësuese të parlamentit nga Aleanca e Grave Deputete për mbështetjen e tyre maksimale.

Zoti Fino, dëshironi të thoni diçka?

Bashkim Fino – Jo.

Eglantina Gjermani - Atëherë, do t'ia jap fjalën zonjës zëvendësministre, Romina Kuka, meqenëse mbulon çështjet vendore në Ministrinë e Brendshme, për të trajtuar në këndvështrimin e saj problematikat dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre.

Do të kërkoja mirëkuptimin e të gjithë të ftuarve, që t'i depozitonin me shkrim problematikat apo shqetësimet, për të respektuar kohën prej 5 minutash, që besoj se është e nevojshme dhe e domosdoshme për të adresuar këto probleme.

Fjala për ju.

Romina Kuka – Faleminderit, zonja Gjermani!

Përshëndetje të gjithëve!

E çmoj dhe e vlerësoj shumë iniciativën tuaj për takimin e sotëm, sepse është e disata herë që ne mbledhemi për të diskutuar çështjen e dhunës në familje. Fatkeqësisht, ne vazhdojmë të kemi një prevalencë shumë të madhe të rasteve të dhunës në familje. Është krimi i parë kundër personit në Shqipëri dhe për vitin 2019 kemi pasur 14 vrasje brenda familjes. Kjo është një kampanë alarmi, që na ngre të gjithëve në përgjegjësinë e të bërit diçka më tepër.

Sigurisht, në vitet e fundit ne kemi pasur rritje të shifrave të denoncimit, por kjo nuk do të thotë se ka pasur më shumë dhunë në familje, por ka pasur më shumë besim tek institucionet për të denoncuar dhunën.

Sipas një raporti të ISTAT-it vlerësohet se 1 në 10 gra denoncojnë dhunën, që do të thotë se nga 4629 raste të denoncuar për dhunë në familje, nëse i shtojmë 10-fish, sot në Shqipëri kemi rreth 40 mijë gra që potencialisht vuajnë nga dhuna në familje.

Unë dua ta nis nga mënyra e përkufizimit se si e kemi konsideruar ne dhunën në familje, ndonëse jemi përpjekur ta adresojmë me ndryshimet ligjore. Fatkeqësisht, kemi konsideruar si dhunë momentin kur e mbijetuara, pasi nuk dua të përdor fjalën “viktima e dhunës në familje”, pëson dhunë fizike. Pra, pragu ku ne konsiderojmë që dhuna ndodh, është momenti i dhunës fizike. Kjo është një nga gjërat që ne duhet të ndryshojmë, të rrisim prapun dhe dhunën ta fillojmë ta konsiderojmë që në momentin e dhunës psikologjike, dhunën verbale, dhunën ekonomike, sepse ka gra që nuk kanë burime ekonomike, prandaj janë të kufizuara nga dhunuesi i tyre. Kjo është një nga mekanizmat e kontrollit që dhunuesi përdor për gruan. Duhet të futemi në thellësi dhe të kuptojmë realisht të gjithë ADN-në e dhunës. Duhet të ngremë prapun për përkufizimin e dhunës dhe të mos konsiderojmë pjesën e dhunës fizike si ngjarje.

Këtu e kam fjalën edhe për pjesën e policisë, e cila, ndonëse në vitet e fundit ka bërë trajnime të ndryshme, në vende të caktuara kemi ende efektivë që nuk e kanë konsideruar në rëndësinë e duhur këtë fenomen, edhe pse kanë marrë masë disiplinore më pas.

Pjesa e dytë, që na shqetëson dhe tregon se ne jemi duke bërë gabim diçka, është sistemi i mospërputhjes së referimit ndërmjet punonjësve në nivelin vendor dhe të policisë. Dua t’ju jap shifrat e sistemit Revalp, i cili përdoret për monitorimin e mekanizmave kombëtarë të referimit.

Për vitin 2019 kemi 645 raste të deklaruara në sistemin Revalp. Ndërkohë, nga Policia e Shtetit, siç e thashë edhe më lartë, kemi 4629 raste. Kjo nxjerr domosdoshmërinë e një rikonfigurimi për mënyrën se si ne i trajtojmë rastet, sepse edhe një rast i vetëm, sidoqoftë, është i rëndësishëm, pasi po flasim për jetë njerëzish, për jetë familjesh. Ne e dimë që dhuna në familje është krim që ndikon te vetë personi, në mjedis, te fëmijët dhe te shoqëria, aq më tepër që dhuna migron.

Një nga propozimet që unë dua të sjell në këtë tryezë, të cilën sigurisht do ta diskutojmë më pas, është që deri më sot çdo institucion ka pasur rolin e vet, patjetër me përgjegjësi ligjore, por ne nuk kemi një menaxher rasti, pra, që në momentin kur diçka shkon keq në një rast të dhunës në familje, pasi e dimë që vrasjet e grave nuk ndodhin menjëherë, por janë të paralajmëruara, ndonjëherë prej një dhune të ndodhur ndër vite, derisa përshkallëzohet dhe arrin në fundin fatal.

Kush mban përgjegjësi për këtë pjesë? Nëse do të mbajë përgjegjësi Policia e Shtetit, ne mund ta diskutojmë, por në këtë moment duhet të konfigurojmë një menaxher rasti, i cili të ketë përgjegjësi ligjore, të marrë ecurinë e vetë disiplinore, të mbajë të gjithë peshën e një rasti dhe të koordinojë me institucionet e nivelit vendor.

A mund ta ketë në përgjegjësi bashkia menaxhimin e rasteve? Mund ta hedhim në diskutim, nëse kemi kapacitetet e duhura. A mund ta ketë policia? Nuk e di se sa mund ta bëjë policia punën sociale. Pra, nevojitet patjetër një bashkëpunim me shërbimet sociale. Këto dua të diskutojmë sot: kush e menaxhon rastin dhe të vendosim në mënyrë urgjente njerëz përgjegjës për çdo lloj rasti, që të shkojnë të trokasin në derën e familjes, të kujdesen për shkollën e fëmijëve, të kujdesen që personat, të cilët kanë pësuar dhunë, të kenë mbështetjen e duhur sociale, sepse nuk mjafton vetëm ndihma ekonomike për të përballuar këtë situatë.

Brenda Ministrisë së Brendshme jemi duke rikonfiguruar edhe mënyrën se si ofrohet shërbimi nga niveli vendor i komisariateve; jemi duke fuqizuar rolin e psikologut dhe, në të njëjtën kohë, jemi duke e bërë më të lehtë mënyrën se si raportohet dhuna. Është e tmerrshme që një grua të bëjë një denoncim në polici dhe forma e denoncimit të jetë e njëjtë si me një krim tjetër. Ajo grua viktimë ka traum psikologjike dhe ndoshta nuk do të flasë për ato çështje, ndaj ne duhet të jemi sa më të kujdesshëm, që edhe mënyra e raportimit të jetë e tillë, që ta lehtësojë atë.

A duhet të kemi shërbimin shëndetësor të pranishëm në atë moment? Për këtë çështje jemi duke diskutuar.

Pika e fundit, që dua të diskutoj për dhunën në familje, ka të bëjë me çështjen e opinionit publik.

Fatkeqësisht, kur kemi raste, sidomos fatale, të humbjes së jetës së grave në marrëdhëniet familjare, shikojmë që mediet humanizojnë autorin. Është e tmerrshme të mundohesh të gjesh arsye pse një person ka kryer krim në familje: humanizimi i autorit, gjetja e arsyeve, shkakut ishte ky apo ai, ndoshta kishte të drejtë që i mori jetën, janë të papranueshme.

Unë e vlerësoj jashtëzakonisht punën që bëjnë gazetarët e terrenit, por ndoshta duhet të bëjmë një takim edhe me mediet për të parë mënyrën se si përcillen këto raste në medie. Është shumë e rëndësishme të ulim tolerancën e fenomenit të dhunës në familje.

E fundit, është për pjesën e pushtetit vendor. Jam shumë e gëzuar që këtu është prezent zoti Fino, me të cilin ne pasnesër do të kemi një takim të posaçëm të pushtetit vendor, për të parë se si strukturat në nivel vendor marrin përgjegjësitë e tyre për sa u përket çështjeve sociale, sidomos për dhunën në familje. Kjo nuk është një çështje dytësore. Kryetarët dhe administrata e bashkisë mund të jenë shumë të ngarkuar me çështjet e tjera, **por çështja e grave** i përket gjithë shoqërisë dhe thyerja e kohezionit, pra, dhuna në një shoqëri, automatikisht sjell edhe nivel më të ulët të jetës në atë nivel vendor.

Përpara se të fillonte ky takim, po diskutoja me zonjën Xhafaj për standardet kombëtare, që ne duhet të përcaktojmë për përmbushjen e detyrimeve që punonjësit social në nivel vendor kanë, pra, koordinatori kundër dhunës në familje, njësitë e mbrojtjes së fëmijëve, e të tjera.

Ka ardhur momenti që ta rregullojmë këtë në nivel qendror me një vendim të Këshillit të Ministrave, me një rezolutë nga Kuvendi, me diçka, e cila jep përgjegjësi në mënyrë të drejtpërdrejtë. Decentralizimi është diçka shumë e mirë, por ka ardhur momenti që për disa çështje, të cilat janë nevralgjike për shoqërinë, ne duhet të marrim kontrollin. Këto ishin katër pikat që unë doja të theksoja.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni - Shumë faleminderit, zonja Kuko!

Nëse nuk gaboj, në fund të vitit 2017 ne kemi miratuar në parlament një rezolutë për parandalimin dhe trajtimin e dhunës ndaj gruas dhe dhunës në familje. Është një program pune gjithëpërfshirës, jo vetëm për parlamentin, por për të gjithë aktorët, përfshirë edhe qeverinë, dhe shumë ambicioz. Në kuadrin e kësaj rezolute, është krijuar edhe nënkomisioni. E gjithë puna që është bërë apo vazhdon të bëhet, qoftë për përmirësimet ligjore, qoftë për monitorimin e legjislacionit, patjetër është pjesë edhe e kësaj rezolute.

Ju falenderoj për të gjitha problematikat dhe sugjerimet konkrete që dhatë! Ne jemi të bindur që, me gjithë ndryshimet ligjore që mund të bëhen, problemin e dhunës nuk e adresojnë dot vetëm ligjet, por duhet ndërgjegjësimi dhe mënyra si e trajtojmë.

Unë do t'ia jap fjalën zonjës Merita Xhafaj, drejtore e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit të Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për të na dhënë në mënyrë të përmbledhur problematikat që janë vënë re në zbatimin e ligjit apo amendimet, sidomos ato të fundit që janë nga parlamenti shqiptar, që janë goxha pozitive dhe besoj kanë ndikuar në punën tuaj, dhe sugjerimet konkrete në mënyrë specifike. Çfarë mund të bëjmë më mirë dhe si mund të bashkëpunojmë më mirë ne si nënkomision dhe si parlament?

Faleminderit!

Merita Xhafaj – Shumë faleminderit, zonja kryetare e Nënkomisionit për Barazinë Gjinore!

Dua ta filloj fjalën time me disa informacione, që mendoj se janë të rëndësishme për t'u njohur Nënkomisioni për Barazinë Gjinore, por edhe të gjithë deputetët.

Për zhvillimet që ka pasur Shqipëria në drejtim të axhendës “Gender” dhe, në mënyrë të veçantë, për shkak se qeveria shqiptare e ka vendosur në prioritetet e saj, ne sot kemi një bashkëpunim të shkëlqyer ndërmjet parlamentit, nënkomisioneve respektive, strukturave përkatëse në nivel qendror, në nivel vendor dhe shoqërisë civile. Për këtë arsye, në Këshillin e Europës, në Komitetin e GREVIO-s, një strukturë monitoruese për Konventën e Stambollit, kemi zëvendës-presidenten shqiptare, zonjën Iris Luarasi, që vjen nga shoqëria civile dhe me një background në medie. Është një vlerësim shumë i madh, sepse ka pasur numrin më të lartë të votave.

Në mbledhjen e fundit të Komitetit të Palëve, në datën 31 janar, shefja e misionit tonë në Këshillin e Europës, zonja Albana Dautllari, është zgjedhur zëvendës-presidente e Këshillit të Palëve. Kjo është një arritje shumë e madhe, që vjen për shkak të rezultateve të arritura nga Shqipëria në drejtim të zbatimit të vazhdueshëm të rekomandimeve të GREVIO-s.

Nga ana tjetër, në zbatim edhe të rezolutës së parlamentit dhe të legjislacionit në fuqi, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, si ministri që koordinon punën me të gjitha institucionet në nivel qendror dhe vendor, por edhe me shoqërinë civile, ka punuar me të gjithë partnerët dhe për herë të parë është prodhuar indeksi për barazinë gjinore për Shqipërinë. Të arrish në vendin e 17-të, mes 28 vende të tjera anëtare të Bashkimit European, përfshirë edhe dy vende të Ballkanit Perëndimor, është një progres. Po kështu, të arrish në

indeksin global për barazinë gjinore vendin e 20-të për vitin 2019, nga vendi i 34-t ku ishin në vitin 2017, është përsëri një arritje. Për të mos thënë pjesën tjetër, që Shqipëria është në top list, vendi i pestë, për përfshirjen e grave në politikbërje dhe vendimmarrje. Natyrisht, një rol të veçantë këtu luan fakti që axhenda e barazisë gjinore është në prioritetet e qeverisë shqiptare.

Për sa i përket temës së sotme që kemi për diskutim, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, i vitit 2011, është baza ligjore për ngritjen e mekanizmave kombëtarë të referimit dhe të një sistemi kombëtar *online* për hedhjen e të dhënave për rastet e dhunës në familje. Po kështu, ligji nr. 47, i vitit 2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, ka dhënë një përkufizim për mekanizmat e referimit, si dhe ka saktësuar dhe ka shtuar përgjegjësi të reja për koordinatorin vendor të dhunës në familje, si personi kyç në këtë mekanizëm.

Sipas përkufizimit të nenit 3, pika 5, mekanizmi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës në familje është rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje. Ngritja dhe funksionimi i mekanizmit është detyrim i pushtetit vendor, i bashkive, ndërsa Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, si autoriteti kryesor përgjegjës për çështjet e dhunës në familje, luan një rol mbikëqyrës për ngritjen dhe funksionimin e këtyre mekanizmave.

Për këtë arsye, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, në partneritet me agjencinë PNUD, kanë punuar gjatë vitit 2019 për të përgatitur analizën e funksionimit të mekanizmave të koordinuar të referimit, të rasteve të dhunës në familje. Në këtë analizë u evidentuan bashkitë në të cilat është formalizuar dhe funksionon mekanizmi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës në familje duke matur edhe efektivitetin dhe funksionimin e tyre.

Nga të dhënat e mbledhura në terren, kryesisht gjatë muajit maj 2019, të përditësuara edhe gjatë muajit tetor, pas konsultimit me grupet e interesit, rezulton se MKR-ja është ngritur në 40 bashki apo në 64% të të gjitha bashkive në vend. E rëndësishme në këtë drejtim është mbështetja e agjencive, partnerëve tanë, agjencive të UN-it, përfshirë këtu PNUD-in-në, UN Women-in, por edhe shoqërisë civile, që kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm me ekspertizën e tyre. Vlerësohet se mekanizmat e referimit janë funksionalë në 35 bashki, në nivele të ndryshme efikasiteti.

Pas përfundimit të analizës në kuadër edhe të fushatës së 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës ndaj grave, gjatë muajit nëntor – dhjetor 2019, mundësuam nënshkrimin e

marrëveshjeve të bashkëpunimit për formalizimin e MKR-ve edhe në 9 bashki të tjera, duke e çuar numrin e MKR-ve në vend në 49.

Në vitin 2020, bazuar edhe në rekomandimet e këtij raporti monitorimi, që është miratuar në Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjimore në mbledhjen e para dy javëve, ku anëtarë janë zëvendësministrat e të gjitha ministrive respektive, përgjegjëse dhe kompetente sipas fushave për ardhjen në ndihmë të viktimave të dhunës, por edhe tre përfaqësues të shoqërisë civile, zonja Ines, zoti Altin dhe zonja Aurela, ne e kemi miratuar këtë raport me komentet përkatëse dhe në zbatim të rekomandimeve të tij kemi planifikuar ngritjen e MKR-ve në të 61 bashkitë e vendit, siç parashikohet edhe në objektivat e strategjisë kombëtare për barazinë gjimore dhe planin e saj të veprimit 2016-2020.

Po kështu, jemi duke punuar edhe në drejtim të fuqizimit dhe rritjes së efektivitetit të të gjithë mekanizmave të koordinuar të referimit. Nga raporti është konstatuar ku çalojnë mekanizmat. Komiteti Drejtues, sikurse e kam raportuar edhe në Këshillin Kombëtar, është hallka më e dobët në arkitekturën e MKR-së. Dihet që Komiteti Drejtues mblidhet me kërkesë të kryetarit të bashkisë. Ekipi teknik ndërdisiplinor ka një bërthamë aktive anëtarësh, e cila përbëhet nga koordinatori kundër dhunës me bazë gjimore në nivel vendor, nga policia, nga organizatat e shoqërisë civile dhe struktura të tjera, sipas vendimit përkatës për ngritjen dhe funksionimin e MKR-ve. Ai ndikohet nga ndryshimi i shpeshtë i anëtarëve dhe kjo nuk është e lidhur vetëm me anëtarët, të cilët janë pjesë e bashkive, por edhe me ata, të cilët janë punonjës policie apo punonjës të strukturave të tjera, zyra rajonale në nivel vendor.

Koordinatori vendor për dhunën në familje është forca shtytëse e funksionimit të mekanizmit të referimit. 23 nga 41 njësitë e qeverisjes vendore kanë një pozicion të koordinatorit kundër dhunës me kohë të plotë, duke forcuar rolin e tyre, kurse të tjerët e kanë koordinatorin që kryen disa detyra njëkohësisht. 26 nga 40 bashki, ku është ngritur mekanizmi i referimit, hedhin të dhëna sistematikisht në sistemin REVALB, kurse të tjerat nuk i hedhin.

Po kështu, në bashkitë, ku puna e MKR-ve rezulton me praktika të mira, sepse duhet ta përmendim edhe këtë, të tilla si zbatimi i programit të strehimit social, zhvillohen takime të rregullta të ekipeve teknike ndërshtetërore, ka filluar buxhetimi gjinor me asistencën e UN Women-it, ka shërbime strehimi dhe shërbime të tjera mbështetëse me asistencën e agjencive UN-it, konkretisht PNUD-it dhe UN Women-it, ka koordinator vendor të trajnuar në atë pozicion pune me kohë të plotë dhe që ka qëndruar në këtë pozicion. Këto bashki janë Tirana, Elbasani, Shkodra, Korça, Bulqiza, Dibra, Durrësi, Kukësi, Pogradeci, Roskoveci, Saranda. Nuk janë ngritur MKR-të në bashkitë Devoll, Këlcyrë, Konispol, Libohovë, Memaliaj,

Poliçan, Pustec, Rrogozhinë, Skrapar, Vorë. Bashkia e Vaut të Dejës nesër ka takimin e parë për të nënshkruar marrëveshjen për ngritjen e mekanizmit të referimit.

Po vazhdon fuqizimi i kapaciteteve në bashkitë Himarë, Klos, Bulqizë, Roskovec, Gramsh, Belsh. Në datën 17, së bashku me ASPA-n, Akademinë e Administratës Publike, ne fillojmë trajnimin e të gjitha pikave fokale të barazisë gjinore, përfshirë këtu edhe koordinatorët për dhunën në nivel qendror dhe në nivel vendor.

Problematikat e hasura janë: koordinatorët vendorë kundër dhunës në familje janë më së shumti punonjës të emëruar nga kryetarët e bashkive për ta kryer këtë detyrë; në pak raste ata i nënshtrohen rekrutimit sipas ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”, në shumicën e rasteve, për rastet e dhunës në familje koordinatorët ngarkohen edhe me detyra të tjera si punonjës i mbrojtjes së fëmijëve.

Ndihma ekonomike e nëpunësit vendor të barazisë gjinore.

Koordinatorët janë trajnuar në vazhdimësi për çështjet e dhunës në familje. Po kështu, mungesa e punonjësve sociale në njësitë administrative, të trajnuar specifikisht për çështjet e dhunës në familje, është përsëri një problematikë. Për shembull, bashkia e Tiranës, që ka 24 njësi administrative dhe 3 lagje, ka vetëm një koordinator vendor të dhunës në familje.

Orari i punës dhe pagesat.

Koordinatorët vendorë në shumë raste punojnë më shumë se sa 8 orë, por natyrisht janë të pa motivuar. Kjo është edhe në rekomandimet e këtij raporti për të gjetur një formë dhe një mënyrë për...

Gjithashtu, ndeshen vështirësi gjatë kryerjes së punës për shkak të paqëndrueshmërisë në disa raste të anëtarëve të ekipit teknik ndërdisiplinor. Kjo sjell vështirësi në koordinim.

Për sa i përket *Job Discription*-it të koordinatorëve, të gjithë kryetarëve të bashkive u është dërguar një letër nga ministrja e Shëndetësisë, të cilët duhet të sjellin komente. Janë përcaktuar cilat duhet të jenë kërkesat dhe kriteret që duhet të përmbushin. Punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve i kanë të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave kriteret që duhet të përmbushin për vendin e punës .

Së fundi, unë vlerësoj shumë faktin, që, edhe ju duhet ta vlerësoni, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale ka mbështetur financiarisht, nëpërmjet fondit social, ngritjen e një sërë shërbimeve në nivel bashkie për ardhjen në ndihmë dhe mbështetjen e shërbimeve për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare. Këto janë në disa qytete. Po kështu, në nivelin e ngritjes së ndërmarrjeve sociale, organizatat e shoqërisë civile kanë marrë

statusin e ndërmarrjes sociale dhe së shpejti do të marrin edhe financimin respektiv për ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, por edhe në të gjitha format e dhunës.

Gjithashtu, mbështetja me financim nga buxheti i shtetit nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të të dyja linjave të këshillimit, të linjës së këshillimit për gra dhe vajza dhe të linjës së këshillimit për fëmijë, është një risi.

Ngritja e qendrës “Lilium” është, gjithashtu, një risi, sepse gjatë vitit të kaluar ne kemi pasur rreth 40 raste viktimash të trajtuara në këtë qendër, me shërbime shumë të specializuara. Kjo është një qendër emergjence 72-orëshe. E njëjta gjë po bëhet edhe nga organizatat e shoqërisë civile në disa qytete, por brenda vitit 2020, ne do të ngremë në nivel vendor, së bashku me bashkitë, edhe tri qendra të tjera në tri bashki të tjera.

Shumë faleminderit!

Koha ishte shumë e shkurtër. Unë kisha goxha informacione për të ndarë me ju, për t’ju treguar që ne jemi duke i kryer të gjitha detyrat. Mbështetja dhe bashkëpunimi me ju janë një çelës suksesi për të arritur aty ku duam. Natyrisht, viti 2019 ka rënie krahasuar me vitin 2018 në rastet e dhunës në marrëdhënie familjare, si dhe në numrin e krimeve brenda familjes, por kjo nuk ka pse të na kënaqë, sepse ne jemi për t’i thënë stop dhunës ndaj grave.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja Xhafaj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit!

Doja të bëja një ndërhyrje, zonja Merita. Ju keni bërë një raport, që ka dy-tri ditë që më ka rënë në dorë dhe rreth këtij raporti e bëtë diskutimin. Raporti ishte shumë i detajuar, me shumë aktorë me interes, edhe të huaj, që unë i falënderoj për ndihmën që kanë dhënë!

Pyetja që kam (po flas në emër të Nënkomisionit për Pushtetit Vendor, të cilin e drejtoj) është: ky raport u është bërë i njohur bashkive të vendit tonë, pra këtyre komiteteve drejtuese, që i keni në skemën përkatëse këtu? I kanë të njohura dhe të specifikuar sipas bashkive? Kjo është çështja e parë, sepse ne duam ta bëjmë këtë sa më shumë objekt diskutimi me ta, që edhe ata të bëhen të vetëdijshëm për të gjitha ato që diskutojmë ne këtu. Kjo është një luftë që nuk mund ta bëjë vetëm një tavolinë e rrumbullakët këtu, por shumë njerëz që duhet të punojnë. E tha edhe zëvendësministrja e Brendshme, e cila foli shumë saktë dhe drejt, por puna është si duhet të ndikojmë të gjithë ne ndaj dhunës në familje.

Tani, kam dy probleme, që dua t'i trajtoj me ju dhe duhet t'i adresojmë e të bëjmë takime me kryetarë bashkish dhe me shoqata, që ky raport ose ky material, që është shumë interesant (madje shumë i mirë), të shkojë tek ata.

Së pari, ju thoni në këtë raport se ka fonde për buxhetimin gjinor dhe përmendni disa shembuj të disa bashkive, për shembull, përmendni Shkodrën për 3 milionë lekë (hiç asgjë) ose bashkitë e tjera, që mund ta kenë më të lartë. Tani, problemi është sa zë ky buxhet në buxhetin e tyre dhe sa është përdorur ky buxhet, në funksion të kësaj që kemi bërë ne. Pra, kjo është një analizë që ne duhet të kërkojmë nga komiteti drejtues atje. Kështu mendoj unë. Kjo është e para.

Së dyti, po ju them diçka, meqenëse ju jeni me eksperiencë dhe mund të na jepni ide dhe mendime, në pushtetin vendor ne kemi edhe funksione të deleguara, përveç funksionit që kanë vetë organet e pushtetit vendor. Doni t'ju jap një shembull? Kemi çështjen e gjendjes civile. Punonjësit e gjendjes civile marrin miratimin nga Ministria e Brendshme, por punojnë për gjendjen civile.

A mos vallë ka ardhur koha, pavarësisht këtyre rasteve që kemi në shoqërinë tonë, të kemi një funksion të deleguar për këtë çështje, në çdo bashki, për të bërë efektive jo vetëm punonjësit që do të merren përditë me këtë punë, por për ta bërë të lëvizshëm edhe komitetin drejtues, për të cilin ju thatë në fjalën tuaj dhe në këtë material që mezi lëviz dhe mezi organizohet?

Këto ishin dy gjëra që unë i pashë shkurtazi dhe dua që, me materialin tuaj dhe me këtë raport përfundimtar që keni bërë, t'i ndihmojmë bashkitë, që edhe ato të mos jenë në hije, të mos bëjnë sikur dëgjojnë dhe shikojnë një material, por të bëjnë një gjë konkrete, sepse po bënë një gjë konkrete dhe t'i japim një funksion të deleguar, të fortë dhe t'i kërkojmë llogari nga ministria juaj, nga Ministria e Brendshme, absolutisht që do të ketë më shumë efekt ndaj dhunës. E thamë, dhuna fizika është e fundit, por ka dhuna të tjera, si psikologjike, verbale, ekonomike e të gjitha me radhë. Këto duhet t'i parandalojnë bashkitë. Duhet të parandalohen nga njerëzit që punojnë atje. Ata duhet t'i ndjekin dhe t'i zgjidhin problemet. Dhuna fizike është e fundit. Mund të ndërhyjë edhe policia e të tjerë, por e kam fjalën për këto 2-3 çështje.

Besoj se edhe shumë organizata jofitimprurëse, që janë sot në këtë tryezë, mund të na ndihmojnë me mendime e sugjerime, që të dyja komisionet, bashkë me Eglantinën, të kenë mundësi qoftë për një rezolutë në parlament, qoftë për disa mendimeve konkrete, që t'ua dërgojmë kryetarëve të bashkive, por bashkëngjitur këtij raporti të dërgojmë

edhe disa mendime konkrete nga të dy komisionet, që mund të mblidhen nesër ose pasnesër për të diskutuar.

E bëra këtë thjesht për të hapur një lloj diskutimi, për të kuptuar edhe unë diçka më tepër, jo se kam ndonjë gjë konkretisht. Raporti më ka pëlqyer, por një raport voluminoz kam përshtypjen se ne mezi e lexojmë, për hir të së vërtetës, dhe jam shumë i bindur që në gjithë këtë tryezë këtu, mund të mos e ketë lexuar shumica, jo më ta lexojnë kryetarët e bashkive!

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zoti Fino!

Faleminderit, zonja Xhafaj!

Në fakt, mbase raportin nuk e lexojnë kryetarët e bashkive, por ne së bashku, si nënkomisione, në 2018-n u kemi çuar nga një letër gjithë kryetarëve të bashkive, atyre që e kanë krijuar mekanizmin e dhunës, atyre që sapo e kanë krijuar mekanizmin, si dhe atyre që nuk e kishin krijuar, duke u kujtuar detyrimin ligjor që kanë, duke i nxitur t'i bëjnë me efikasë mekanizmat dhe duke i kërkuar informacion për problematikat që janë vënë re dhe konkretisht se çfarë mund të bëjmë ne si parlament, si nënkomision apo të gjithë bashkë si aktorë për ta adresuar këtë gjë.

Edhe unë doja t'i falënderoja të gjithë përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare, që kanë ndihmuar fort në krijimin e mekanizmit kundër dhunës në një pjesë të mirë të bashkive!

Sërish në cilësinë e kryetares së nënkomisionit u kam dërguar nga një letër gjithë kryetarëve të bashkive. Besoj se kur ta marrin fjalën përfaqësuesit e shoqatave të pushtetit vendor do të na japin më shumë informacion dhe do të kërkojmë bashkëpunim më të ngushtë me ta epur të adresuar problemin.

Edhe një herë, shumë faleminderit për punën që keni bërë dhe për prezantimin! E di që koha ishte e shkurtër, por doja të flisnim më konkretisht çfarë duhet të bëjmë. Vërtet rastet e dhunës mund të kenë qenë më pak vitin e kaluar, por ka pasur krime makabre, që na kanë shqetësuar dhe tronditur. Çështja është si mund të punojmë më fort për t'i parandaluar, ky është angazhimi kryesor i të gjithë aktorëve, se sa t'i trajtojmë rastet. Jemi këtu për t'i diskutuar të gjitha këto.

Do t'ia jap fjalën zonjës Iris Aliaj, këshilltare në Ministrinë e Drejtësisë. Do të doja nga ju, në mënyrë të përmbledhur, informacione konkrete, si dhe sa institucionet e drejtësisë japin kontribut në mekanizmat e referimit kundër dhunës, por edhe një informacion

pak më të përmbledhur për ligjin “Për ndihmën juridike falas”, aktet nënligjore dhe sa po ndihmohen gratë dhe viktimat e dhunës.

Faleminderit!

Iris Aliaj – Faleminderit, e nderuar zonja Gjermani!

Së pari, më lejoni t’ju falënderoj që na keni thirrur në këtë takim, i cili është shumë i rëndësishëm, pasi, ashtu siç e përmendën të gjithë parafolësit e tjerë, është e rëndësishme qasja që ju keni parashtruar edhe në këtë tryezë, sepse çështjet e dhunës në familje apo çështjet e dhunës me bazë gjinore na përkasin të gjithëve dhe ne duhet të punojmë të gjithë bashkë!

Më vjen mirë që sot janë prezentë përfaqësuesit më të rëndësishëm të institucioneve, që kanë detyrime konkrete në kuadër të zbatimit të legjislacionit për dhunën në familje, por, nga ana tjetër, edhe përfaqësuesit nga organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare.

Së dyti, do të ndalem pak tek angazhimet që Ministria e Drejtësisë ka ndërmarrë në kuadër të zbatimit të të gjitha detyrimeve që kemi ne, si ndaj legjislacionit shqiptar, ashtu edhe ndaj konventës së Stambollit, si dhe ndaj rekomandimeve që ka dhënë grupi i ekspertëve GREVIO.

Më lejoni të ndaj me ju angazhimin maksimal të ministres Gjonaj për këto çështje, si në nivel të miratimit të të gjitha akteve nënligjore dhe legjislacionit, ashtu edhe në ofrimin e shërbimeve konkrete dhe në koordinimin e punës edhe me aktorë të tjerë.

Siç jeni në dijeni, Ministria e Drejtësisë, duke bashkërenduar punën edhe me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, ka ngritur një zyrë pranë ministrisë, e cila është konsideruar si zyra e koordinimit të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Aktualisht, në bashkëpunim edhe me Këshillin e Lartë Gjyqësor, ne jemi në përfundim të nxjerrjes së urdhrin, i cili do të përmbajë të dhëna që lidhen me çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare. Të gjitha këto të dhëna do të na ndihmojnë në nivel politikash për të adresuar dhe për të parë më nga afër se cilat janë problematikat. Një nga rekomandimet që ka dhënë grupi i ekspertëve GREVIO janë të dhënat që lidhen me çështjet e dhunës në familje. Pra, duke qenë se deri tani nuk kemi pasur të dhëna të sakta, në njëfarë mënyre, na kanë penguar për të adresuar edhe në nivel politikash se ku janë problematikat dhe çfarë hapash të mëtejshme duhet të marrim ne si institucione përgjegjëse.

Ju e përmendët, me të drejtë, ligjin “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, i cili lidhet drejtpërdrejt me aksesin. Ligji ka parashikuar viktimat e dhunës si subjekte të posaçme të tij.

Ministria e Drejtësisë i ka përfunduar pothuajse të gjitha aktet nënligjore. Aktualisht, aktet e vetme nënligjore që kanë mbetur për miratim janë ato që lidhen me tarifat për avokatët, por edhe sistemi i rrotacionit të avokatëve në proceset civile. Këto janë dy aktet e fundit, që ne shpresojmë të përfundojnë në muajin shkurt ose në fillim të muajit mars. Kështu që, me këto akte përfundon gjithë paketa legjislative për ligjin “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Mirëpo, fakti që këto akte nuk kanë dalë, nuk do të thotë se ligji nuk ka filluar zbatimin e tij. Ministria ka filluar të hapë edhe zyrat e ndihmës juridike parësore. Aktualisht ne kemi një zyrë, që është funksionale, në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë, është hapur një zyrë në Elbasan dhe jemi duke hapur zyra edhe në qytete të tjera të Shqipërisë, me qëllim që viktimat e dhunës apo subjekte të tjera të posaçme të ligjit, të kenë mundësi të përfitojnë nga këto shërbime.

Aktualisht, për sa i përket zbatimit të ligjit “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, jemi duke lidhur edhe marrëveshje bashkëpunimi me klinikat e ligjit, që janë ngritur pranë institucioneve arsimore, por, nga ana tjetër, edhe me organizatat e shoqërisë civile. Shumë shpet do të dalë thirrja dhe organizatat do të kenë mundësi të aplikojnë dhe të bëhen ofruese të shërbimit të ndihmës juridike parësore. Ndërkohë, ka filluar puna dhe ka një sërë rastesh për sa i përket çështjes së ndihmës juridike dytësore, që lidhet me përfaqësimin me avokat.

Në fjalën time dua të ndalem edhe te problematikat. Jam shumë dakord edhe me çështjen që ngriti zoti Fino për mekanizmat e rinj. Kjo është një çështje që duhet ta diskutojmë edhe ne këtu. Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” ka filluar zbatimin e tij që në vitin 2006. Përpos gjithë angazhimit, si nga ana e institucioneve shtetërore, ashtu edhe nga organizatat e shoqërisë civile, përsëri hasim një sërë problematikash dhe rastet e dhunës, vrasjet, në disa momente kanë ardhur duke u shtuar dhe në disa të tjera shifrat zvogëlohen, por këto janë elemente që duhet të na bëjnë të mendojmë për mekanizmat të rinj.

Në këndvështrimin tim, duke qenë se para se të bëhesha pjesë e Ministrisë së Drejtësisë kam qenë goxha e angazhuar me çështjet e dhunës me bazë gjinore, mendoj se mekanizmat e dhunës në nivel vendor, që të bëhen funksionalë, duhet të ndryshojë pak sistemi, çështja që e ngriti edhe zoti Fino. Kjo do të thotë se në qoftë se marrim rastet e denoncimeve të dhunës, pjesa më e madhe e denoncimeve të dhunës në familje bëhen pranë komisariateve të policisë ose pranë policisë. Pse të mos mendojmë mekanizma që koordinatorin vendor apo një punonjës psikolog, social nga Shërbimi Social Shtetëror, ta afrojmë dhe ta vendosim pranë komisariateve të policisë? Në momentin kur viktimat paraqitet

dhe policia kryen të gjithë mekanizmat e saj për hartimin e kërkesëpadisë për urdhrin paraprak të mbrojtjes së menjëhershme, për vlerësimin e riskut, koordinatori vendor koordinon gjithë punën me aktorët e tjerë, për të marrë shërbimet e ndihmës juridike parësore apo dytësore, shërbimet shëndetësore, bashkërendimin e punës edhe me institucionet shtetërore, por edhe me gjithë ofruesit e tjerë të shërbimeve. Ky është një mekanizëm i ri.

Eglantina Gjermani – Më fal! E ke fjalën për ndryshimin e VKM-së së 2011-s? Këtë po sugjeron apo praktikisht...?

Iris Aliaj – Unë po fals praktikisht për mekanizma të rinj. Duke qenë se këtu ka aktorë shumë të rëndësishëm, do të thotë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eglantina Gjermani – Kemi një VKM të 2011-s. Sugjerimi juaj është të bëhet tërësisht një gjë e re e mekanizmit, duke funksionuar kështu siç ju sugjeroni apo ndonjë ndryshim ligji? Nuk jam e qartë.

Iris Aliaj – Ky është një element që edhe mund ta diskutojmë në vijimësi, por mund të gjenden edhe forma më të thjeshta për ta realizuar. Në qoftë se do të jetë e nevojshme, se duhet diskutuar në detaje më konkrete, kjo çështje mund të diskutohet më tej, se si do të jetë formati kur të arrijmë deri aty. Në qoftë se do të jetë e nevojshme të ndryshohet kjo VKM, mund të nxjerrim një urdher të përbashkët nëpërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë, për të krijuar, le të themi, fizikisht, pozicionin e koordinatorit apo të një punonjësi tjetër, jo domosdoshmërisht koordinatorit, në qoftë se nuk vlerësohet se mund të jetë një mekanizëm efektiv.

Gjithashtu, përveç këtij mekanizmi të ri, po aq e rëndësishme është edhe puna me ekspertët, me profesionistët që zbatojnë ligjin. Kjo do të thotë se jo vetëm gjyqtarët, prokurorët, avokatët, punonjësit e policisë dhe gjithë aktorët, që ligji i ka përcaktuar shumë qartë se kush janë, duhet të kenë patjetër trajnime. Duhet të ndryshojë pak edhe formati i mënyrës se si trajnohen profesionistët. Ka ardhur koha që profesionistët të marrin trajnime, të cilat janë pak më të thelluara, që ne të ndalemi pak edhe tek roli që kanë stereotipet gjinore, sepse ligji nuk zbatohet edhe për shkak të mentalitetit apo dhe gjithë stereotipeve gjinore që ka shoqëria shqiptare.

Për ta përmbledhur, që të mos zgjatem më tepër, që të mos ju marr shumë kohë, pak shumë këto janë të gjithë elementët, jo vetëm puna me viktimat e dhunës, por edhe puna me dhunuesit. Programet rehabilituese, që në fakt janë programe shumë të mira rehabilitimi, por është e nevojshme që këto programe të përhapen edhe nëpër qytete të tjera.

Ju falënderoj shumë! Ndërkohë, jam shumë e hapur edhe për diskutime të tjera. Kam kënaqësinë t'i dëgjoj edhe të gjithë kolegët, që janë prezent këtu.

Faleminderit!

Eglantina Gjermani – Shumë faleminderit, Eris! Faleminderit edhe për prezantimin, edhe për sugjerimet konkrete!

Pa humbur kohë, do të doja të vazhdoja me përfaqësuesit e pushtetit vendor dhe dy shoqatave. Le ta fillojmë me zonjën Adelina Farici, Shoqata për Autonomi Vendore. Do të doja të flisnit në mënyrë të përmbledhur. Në fakt, u tha nga zonja Xhafaj, në lidhje me bashkitë që nuk e kanë krijuar mekanizmin, u tha edhe bashkitë që punojnë në mënyrë më efektive për trajtimin e viktimave dhe të të mbijetuarve të dhunës.

Unë do të doja të dija në lidhje me problematikat që ju keni vënë re, si dhe angazhimin konkret me bashkitë që nuk e kanë krijuar këtë mekanizëm, apo që e kanë krijuar, por nuk është edhe aq efikas. Konkretisht, na thoni se si mund t'ju ndihmojnë edhe ne.

Faleminderit!

Adelina Farici – Në rregull! Në fakt, edhe për efekt kohe, unë do të përpiqem të mos përsëris kolegët. Ajo që u evidentua me forcë këtu, është roli shumë i madh ose roli vendimtar e parësor i pushtetit vendor në lidhje me këtë çështje që adresohet sot nga nënkomisioni. Paralelisht duhet të marrim në konsideratë se sa kanë mundësi bashkitë ta ofrojnë këtë lloj shërbimi. Nga komunikimet që kemi ne, por edhe nga studimet e kryera, është vënë re se, së pari, se në disa bashki nuk është plotësuar standardi ligjor për ngritjen e mekanizmit të referimit të dhunës, gjë që është e pafalshme për ato bashki.

Së dyti, në fakt diçka që nuk varet shumë nga bashkitë, është mungesa e burimeve njerëzore të trajnuara dhe të kualifikuara për ofrimin e këtyre shërbimeve. Bashkitë duhet të ofrojnë shërbim mbështetës, konsulencë psikologjike, konsulencë juridike. Ne duhet të jemi koshient dhe të flasim për situatën reale ku jemi. Nuk është se bashkitë i kanë këto kapacitete dhe këto aftësi, që t'i ofrojnë. Madje, në shumë bashki koordinatori i dhunës kryen paralelisht edhe funksione të tjera. Domethënë, këtë e ka si funksion të dytë, jo parësor. Që nga ky moment kuptohet e do të ketë probleme me funksionimin e këtij mekanizmi.

Në fakt, një nga gjërat më të lehta për t'u bërë nga pushteti lokal, është mbledhja permanente e komisioneve përkatëse, dhe nëpërmjet këtyre komisioneve të bëjë koordinimin mes institucioneve. Referuar studimeve të bëra, statistikave dëshmojnë se nuk është se kemi një mbledhje permanente të komitetit, të grupit të referimit të dhunës, që përbëhet nga gjithë

këto institucione, ku rolin kyç këtu e ka pushteti vendor. Ne jemi këtu, në fakt, si mbrojtës të pushtetit vendor, por në kushtet aktuale jemi me mangësi të shumta.

Ajo që do të sugjeroja, është se duhet të gjendet një mënyrë e koordinimit të institucioneve. Pushteti vendor është pushteti që merret direkt me këtë çështje, por faktikisht sensibilizimi qytetar nuk është në këtë drejtim.

Në momentin që kemi raste të referimit të dhunës, ndodh rrallë që drejtohen te pushteti lokal, sepse shumica drejtohen te komisariati. Për këtë arsye, mendoj është shumë i nevojshëm sensibilizimi qytetar, pasi pushteti vendor ka rolin e parandaluesit. Nëse këto probleme do të evidentohen që në gjenezë, mendoj se mund t'i parandalojmë raste flagrante të dhunës, e ç'është më e rënda, rastet e vrasjeve.

Këtu, roli i shoqatës është që, së pari, të bashkëpunojë po ashtu me ministrinë dhe aktorët ndërkombëtarë, për asistimin e bashkive. Pra, bashkitë duhet të asistohen për kompletimin e të gjithave me sistemin e referimit të dhunës. Ajo që shohim është se, edhe kur është sistemi, jo të gjitha bashkitë e përditësojnë sistemin me të dhëna. Kjo do të thotë se ka mungesë kapacitetesh.

Roli tjetër, e në lidhje me këtë do të kërkojmë edhe mbështetjen e donatorëve, ka të bëjë me: së pari rritjen e kapaciteteve në bashki për evidentimin dhe koordinimin me institucionet përkatëse, dhe së dyti ofrimin e shërbimeve në këtë drejtim.

Një sugjerim tjetër është se duhet të bëhet edhe një koordinim më i mirë me një monitor ose rregullator mbase edhe kombëtar, shërbim social kombëtar. Ndoshta pushteti vendor duhet të ketë një protokoll raportimi mujor në lidhje me rastet e referimit dhe problematikat. Jo vetëm për problematikat që janë evidentuar, po paralelisht edhe për pengesat që has pushteti vendor në ofrimin e shërbimeve, në mënyrë që të kemi një koordinim midis institucioneve, që të shkojmë drejt rritjes së kapaciteteve të bashkive, që bashkitë të mund ta kryejnë në mënyrë të plotë funksionin e tyre. jemi koshientë që, në këto momente, bashkitë nuk mund ta kryejnë në mënyrë të plotë këtë funksion.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja Farici!

Në fakt, është detyrim ligjor. Bashkitë e kanë detyrim, përgjegjësi ta kryejnë. Mbase nuk e kryejnë dot sipas cilësisë që kërkojmë apo sipas pritshmërive që kemi, ngaqë s'kanë kapacitete, por kjo nuk justifikon moszbatimin e ligjit.

Bashkim Fino – Ajo e shprehu mendimin e saj. Kot bën koment, bashkëkryetare! E shprehu mendimin e saj. Thuaji faleminderit! Kush ka tjetër? Nuk ka ç'të thotë më shumë

ajo. Sado komente t'i bëjmë ti dhe unë, e në këtë pikë jam dakord, nuk ka ç' thotë ajo. Është shoqatë.

Të vazhdojë ai tjetri, të dëgjojmë, të mbajmë ndonjë shënim, sepse po t'u bëjmë koment atyre që thonë këta, i bie t'i kemi thirrur kot pastaj, se e bëjmë vetë këtë.

Më fal për ndërhyrjen, por desha të ishim pak më praktikë. Se mos bëra ndonjë gabim, se jam edhe mashkull dhe duket sikur pa dashje bëra dhunë direkte. Më fal!

Eglantina Gjermani – Zoti Agron, në fakt, mendimin tuaj na e keni nisur edhe me shkrim. Ju lutem, zoti Agron Haxhimihali, shoqata e bashkive, fjala për juve!

Agron Haxhimihali – Faleminderit, zonja Gjermani!

Në fakt, unë e kam dërguar një përmbledhje, pasi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fakt, e kam dërguar materialin tim, mund ta përditësojmë gjatë gjithë kohës, por sipas principit tim, në takime të kësaj rëndësie nuk duhet të flas për konstatime, nuk duhet të flas për statistika, por si organizatë lobuese vijmë me një qasje për të propozuar zgjidhje.

Problemi është madhor. Mjafton të lexosh një raport nga kolegja Arqimandriti, kur një bashki, së cilës s'po ia përmendim emrin, ka pasur 400 raste denoncimi në polici dhe zero raste trajtimi në bashki. Kjo tregon se kemi nevojë ta *set up*-im këtë lloj sistemi.

Çfarë kam propozuar këtu? Së pari, ne kemi një VKM të vitit 2011. Pas reformës territoriale, e mbase kjo është çështje që do ta diskutojmë pasnesër, me zonjën zëvendësministre dhe me zotin Fino, ne tashti duhet ta ndryshojmë kuadrin ligjor. Nuk mund të vazhdojmë të punojmë ende me ligjet e vitit 2011, të cilat u referohen komunave apo njësisive të tjera. Pra, ligjin nuk e kemi të apdejtuar. Kaq mjafton për të thënë se nuk jemi korrektë me kohën.

Pra, duhen bërë ndryshime ligjore, dhe kjo është qasja ime e parë, qasja institucionale. Në fakt, mua më vjen keq, sepse kam një jetë që punoj me bashkitë, por është më mirë që, para sa të mbroj interesin e tyre, të mbroj interesin e përgjithshëm në lidhje me këtë çështje.

Nga pikëpamja institucionale, mendoj se bashkitë e kanë barrë shumë të madhe këtë. Ne po vëmë re se për sa kohë që nuk po përmbushet misioni i tyre për shërbimet publike, kjo qasje me të padrejtë ju duket sekondare. Fakti që nuk e kanë realizuar, është diçka që duhet ta shikojë qeveria. Ne të gjithë, siç zonja zëvendësministre e përmendi nga një këndvështrim tjetër, është e nevojshme të ndryshojmë mënyrën, qasjen, duhet të organizojmë institucionin.

Unë kam hedhur këtu hipotezën e rajonalizimit të këtij mekanizmi ose të kësaj qasjeje. Në fakt, mund të jem edhe kontradiktor me veten, sa i takon decentralizimit apo dhe

mënyrës se si janë organizuar bashkitë, por fakti që nuk po na funksionon më mirë, fakti që edhe sot kemi bashki të mesme e të vogla, është e vështirë t'u thuash të mbledhin komitetin e referimit, të thërrasin gjykatësin, këtë apo atë. Më duket se nuk funksionon mirë as vendimmarrja, autoriteti, fizibiliteti. Me gjithë respektin e të zgjedhurve, bashkitë nuk kanë aty ku duhet. Prandaj, mendoj se duhet riparë i tërë sistemi, për ta rajonalizuara këtë shërbim në disa qendra të mëdha.

Këtu u përmend se keni organizuar qendra këtu e qendra atje, zyra këtu e zyra atje. Mendoj se qeveria duhet t'i riorganizojë këto, që të shkëputemi një herë e mirë nga fragmentarizimi i burimeve njerëzore, por edhe i burimeve financiare. Duhet të gjejmë mekanizma të tjerë. E them me keqardhje se statistikat tregojnë që bashkitë kanë ndërtuar 43 të tilla, por raporti tregon se këto 43 të tilla nuk trajtojnë asnjë gjë. Ne flasim për statistika, por thelbi është gjë tjetër.

Po në këtë kontekst, mendoj se duhet ta riorganizojmë ndryshe këtë mekanizëm dhe t'u kushtojmë vëmendje burimeve njerëzore, me qëllim që të merren me këtë çështje. Nuk mund të themi se kjo bashki jep sot asistencë e këshilla të mira ligjore për gratë me probleme, por nuk po e bëj, sepse vëmë re se nuk po funksionon për gjëra të tjera. Nuk mund të themi se i menaxhon mirë çështjet sociale apo se është mjaft efektive te shërbimi shëndetësor.

Ajo që mund të bëjmë, për shembull, janë çështjet ekonomike, siç u përmend këtu, a e japin atë ndihmën ekonomike. Por a është pikërisht vetëm ky roli i bashkisë, thjesht ndihma ekonomike që jep qeveria?

Pra, unë shikoj qasjen që sikur s'po gjejmë rehat. Edhe referuar eksperiencës sime, qëkur ka dal VKM-ja në 2011-ën, kemi punuar së bashku me agjencinë suedeze, për ta zbatuar në të 308 komunat e Shqipërisë. Për më tepër, duhet ta pranojmë se i bëmë PR ligjit, si një e drejtë e madhe, statistikat i kishim mirë, por në komuna ishte e vështirë të ndërtoje mekanizma, ishte e vështirë edhe për gratë të shkonin nëpër komuna, pastaj mentaliteti, kultura që askush nuk troket.

Duhet të pranojmë se sot besojnë më shumë te Policia e Shtetit. Kjo nuk është ndonjë gjë e keqe, por e them si fakt, që të shikojmë qasjen në këtë drejtim.

Pak më parë u përmend se sa buxhet ndan qeverisja vendore. Ne duhet ta pranojmë: kanë aq buxhet sa kanë, por nuk është se ndajnë, nuk është se kanë buxhet të strukturuar për këto çështje. Unë nuk e quaj buxhet, nëse ke ndarë njëherë 1 milionë lekë, 2 milionë, 3 milionë. Unë quaj buxhet strukturor nëse e mbulon këtë çështje në rastin që ndodh në bashki. Po ndodhi kështu, unë i heq kapelen bashkisë dhe institucionit që mbulon këtë çështje. Në të

kundërt, nëse nuk e bën, duhet të gjejmë zgjidhje asimetrike. Në këtë rast nuk na prish punë decentralizimi.

Kaq kisha. Jemi në kontakt. Mund t'i shikoj sërish këto, me ekspertët e mi, mbase për t'i thelluar më tej e për të ardhur në një qasje tjetër.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Shumë faleminderit, zoti Haxhimihali!

Do të vazhdojmë edhe me përfaqësuesit e shoqërisë civile. Siç tha zoti Fino, ne si nënkomision, por edhe si Aleancë e grave deputete do të mblidhemi sërish, duke marrë në konsideratë të gjitha sugjerimet e rekomandimet tuaja të shprehura sot, por edhe ato me shkrim, për të pasur një platformë pune dhe për t'i marrë në konsideratë, nëse mund të bëhen ndryshime ligjore, nëse ka nevojë për monitorim më të mirë, nëse ka nevojë për të ndryshuar VKM-të, duke iu drejtuar të gjitha institucioneve respektive.

Fjalën ia jap zonjës Iris Luarasi, drejtuese e linjës së këshillimit për gratë dhe vajzat, e cila ka edhe një program për burrat dhunues.

Fjala është për ju, lidhur me mekanizmin dhe punën tuaj, si dhe për sugjerime konkrete, se çfarë mund të bëjmë ne për ta adresuar këtë situatë.

Faleminderit!

Iris Luarasi – Faleminderit!

Në fakt ne, bashkë me organizata të tjera, kemi qenë iniciatore të ligjit kundër dhunës në marrëdhëniet familjare. Është i vetmi ligj i parlamentit shqiptar, që ka ardhur si iniciativë e shoqërisë civile. Kësisoj, jemi brenda gjithë procesit të këtij ligji. Më pas, sigurisht, edhe me implementimin e bashkive të para për mekanizmin e referimit. Këtu ka përfaqësuese të rrjetit, si Mirela, Aurela, Eda Haxhiymeri, Streha për gratë e dhunuara, Refleksione dhe CEMT-ja.

Kësisoj, e njohim sistemin që nga fillimi, qysh me zbatimin e tij në fillim të 2007-ës, kur ligji hyri në fuqi. Një nga gjërat e rëndësishme që kemi parë gjatë gjithë kësaj eksperience, është dëshira e mirë ose jo e kryetarëve të bashkive.

Në ato vende ku kryetari i bashkisë e kupton absolutisht problemin, e merr seriozisht, sistemi është absolutisht i garantuar dhe funksionon shumë mirë, me buxhete e pa buxhete. Ndonjëherë është dëshira e mirë politike për të funksionuar mekanizmat. Siç na ka treguar praktika gjatë gjithë këtyre viteve, në rastin kur mungon ndërgjegjësimi dhe informacioni, kur nga ana e kryetarit të bashkisë kjo merret si një nga gjërat më të parëndësishme që ka bashkia, atëherë sigurisht që problemit vjen duke i rënë rëndësia, duke filluar që nga kupola drejtuese e deri më tutje.

Praktikisht, me ndihmën e agjencisë austriake për zhvillim jemi duke implementuar dhe duke krijuar mekanizmin e referimit në tri bashki të vendit, të cilat janë bashki të vogla: Këlcyra, Rrogozhina dhe Devolli. Deri më parë ishim mësuar të punonim me bashkitë e mëdha, ku në fakt është shumë më e thjeshtë për ta ndërtuar sistemin e mekanizmit të referimit, ku sistemi vërtetë funksionon. Në lidhje me atë që shohim në bashkitë e vogla, po marrim rastin e fundit për shembull, atë të Këlcyrës, duhet të thërrasësh drejtoreshën e shërbimit rajonal social, që vjen nga Gjirokastra. Drejtoresha e shërbimit social, që është në Gjirokastrë, mbulon edhe qytetin e Përmetit, edhe të Gjirokastrës. sa do të ketë mundësi dhe kohë fizike ajo, për të shkuar në të gjitha mbledhjet e komitetit drejtues, që parashikohen sipas VKM-së së 2011-ës.

Kjo është një nga gjërat që ne duhet ta marrim në konsideratë dhe ta rishohim. Në bashkinë e Këlcyrës apo në bashkinë e Rrogozhinës, ku nuk ka gjykatë, ku nuk ka prokurori, ku mungojnë institucionet e rëndësishme, këta njerëz duhet të vijnë nga qytete të tjera, që janë përgjegjëse për këto bashki të vogla.

Në fakt, ne kemi filluar të kuptojmë sikur po bëjmë një gjë që, e cila është gati e pamundur, sepse kryetarët e bashkive, të cilët që të tre kanë qenë vërtet shumë të motivuar, janë duke bërë telefonata personale për të kërkuar asistencën dhe pjesëmarrjen e këtyre njerëzve në takimet që parashikohen sipas ligjit. Kjo është e para.

E dyta do të thosha se është roli i policisë. Në fakt, qëkurse kemi bërë vlerësimin e dy projekteve që kanë qenë konsideruar si shumë të suksesshme nga UN Trust Fund, një nga rekomandimet ka qenë forcimi i rolit të policisë, dhe nëse mekanizmi duhet të shkojë pranë sistemit të policisë, që është 24 orë, ndërkohë që e dimë mirë se sistemet vendore punojnë vetëm tetë orë në ditë, nga ora nëntë deri në orën 17. Pra, çfarë bëhet me viktimat, kur dhuna ndodh pas orës 17.

Unë drejtoj një organizatë, që është 24 orë në ditë, shtatë ditë të javës, që e ofron këtë shërbim, por nuk mjafton një organizatë për të mbuluar me asistencë gjithë Shqipërinë. Pavarësisht se na ka ndodhur të marrim telefonata edhe në orën tre të natës dhe është referuar, prapë duhet referuar te shërbimi i policisë, sepse në orën tre të mëngjesit nuk mund ta referosh në asnjë nga institucionet vendore.

Element tjetër i rëndësishëm është ajo që tha edhe zëvendësministrja, është roli i medias, sepse, për hir të së vërtetës, të gjitha rastet e fundit dëshmojnë se më shumë po bën dëm se sa po bën mirë në lidhje me raportimet e dhunës në familje, duke nxjerrë në të gjitha portalet, por edhe nëpër gazeta prestigjioze, edhe në emisione, justifikime që përlligjin arsyen se pse një autor vrau viktimën e dhunës në familje.

Kështu, dy gjërat kryesore që do të thosha janë: trajnimi i vazhdueshëm i forcave të policisë, sepse ka vende ku gjejmë mbështetje, por ka vende ku gjejmë edhe njerëz absolutisht të patrajtuar dhe që nuk dinë ç'të bëjnë me viktimën. Mendoj se ka lidhje me takimet që duhen bërë nga komisioni juaj. Nuk e di se cilat janë mekanizmat që duhet të përdorni për të ndërgjegjësuar kryetarët e bashkive në lidhje me rëndësinë që ka ky element. E fundit fare, por jo për nga rëndësia, ka lidhje me rehabilitimin e burrave dhunues. Në këtë rast ka lidhje të drejtpërdrejt me rolin e gjykatave.

Ne kemi që në 2012-ën një linjë që funksionon në lidhje me rehabilitimin e dhunuesve. Në 2019-ën kemi pasur 100 raste të burrave dhunues, të cilët janë rehabilituar. Kemi vetëm gjashtë raste nga gjykata, që në fakt duhet të ishte provajderi kryesor me referim të rasteve.

E tha pak më parë edhe Iri si nga Ministria e Drejtësisë, elementi tjetër që do ta ndihmonte jashtëzakonisht shumë sistemin e referimit, do të ishte ndihma ligjore falas, e cila ofrohet vetëm nga disa zyra që ka krijuar Ministria e Drejtësisë, por që sigurisht ofrohet edhe nga organizata si ajo e Aurelës, e jona, si dhe nga shumë organizata të tjera nëpër rrethe, por që është e gjitha e financuar nga donatorët. Ka ardhur koha të ketë financime nga shteti në lidhje me këtë pjesë. U gëzova që Iri si tha se shumë shpejt do të ketë një financim nga ministria në lidhje me këtë gjë.

Faleminderit!

Eglantina Gjermani – Shumë faleminderit, zonja Luarasi! Faleminderit edhe për punën që bëtë, si dhe për prezantimin e sugjerimet konkrete!

Në fakt, lidhur me takimet me kryetarët e bashkive apo me punën për të parë mekanizmin e referimit të dhunës, komisioni ka një praktikë të mirë, duke bërë vizita në bashki të ndryshme. Edhe tani, në programin e punës kemi vizitat nëpër bashkitë ku janë krijuar mekanizmat, për t'i takuar të gjithë aktorët, për të vlerësuar dhe motivuar punën, por edhe aty ku mekanizmat nuk janë krijuar ende, me qëllim që të jemi në kontakt personal me ta. E kemi në planin e punës dhe do ta vazhdojmë sërish.

Fjalën ia jap zonjës Mirela Arqimandriti, drejtuese e qendrës Aleanca gjinore për zhvillim, që kohët e fundit ka kryer një raport të hollësishëm monitorimi në disa bashki, në lidhje me mekanizmat e referimit të dhunës.

Ju lutem, problematikat dhe sugjerimet tuaja.

Mirela Arqimandriti – Po! Faleminderit!

Përshëndetje të gjithëve.

Së pari falënderoj komisionin në lidhje me gjithë predispozicionin për ta trajtuar këtë çështje së paku dy herë brenda gjashtë muajve të fundit për të gjitha ndryshimet ligjore që janë bërë falënderojmë të gjithë grupin e deputeteve të Shqipërisë, sepse pa ato nuk do të ishte përforcuar kaq shumë ligji “Për masat e dhunës në familje”.

Përpara se të them këto gjëra që i kemi konstatuar prej 3 vjetësh, dua të falënderoj të gjithë ata që kanë kontribuar, Irisi i përmendi pak, duke përfshirë edhe donatorët: UNDP-në, *UN Woman*, për ngritjen e mekanizmave të referimit, si dhe vetë personat në terren, të cilët i kam parë personalisht në shumicën e bashkive, disa prej të cilëve përpiqen me mish dhe me shpirt t’i ndihmojnë sa më shumë viktimat.

I gjithë ky konkluzion është për shkak se ka shumë mangësi në aspektin teknik dhe financiar që kjo punë të kryhet siç duhet. Duke marrë shkas dhe nga të gjitha hipotezat që u hodhën këtu për ndryshime të rëndësishme ligjore lidhur me atë se cili do ta mbajë këtë kapele dhe do të mbajë përgjegjësi ligjore për trajtimin e viktimave të dhunës dhe në rastin e një vrasjeje si këto që kanë ndodhur së fundi apo vitin e kaluar duhet të kthehemi mbrapa dhe të fillojmë të gjejmë se cili është përgjegjësi, që ndodhi kjo vrasje. Ai duhet të fillojë të mbajë përgjegjësi ligjore. Ai duhet të jetë personi i një institucioni shtetëror, të cilin po të ulemi të gjithë bashkë përtej kësaj tryeze ne munda ta zgjidhim shumë mirë edhe në propozimet që u dhanë si nga Ministria e Brendshme, nga zoti Haxhimali apo dhe nga Ministria e Drejtësisë. Janë gjëra që edhe shoqëria civile i ka diskutuar dhe më parë.

Alda po shpërndan fletët që kemi bërë, janë monitorim i vërtetë, në kuptimin që nëse thuhet se është mbledhur një herë komiteti drejtues, kemi minutat, kemi fotot. I kemi kërkuar bashkisë materiale që ta vërtetojë, nëse është bërë kjo mbledhje apo ky trajtim i rasteve të dhunës në familje. Siç e shikoni 6 bashkitë kryesore të Shqipërisë kanë trajtuar pothuajse më pak se 10% të rasteve të urdhrave të grave që kanë kërkuar urdhra mbrojtjeje, i kanë marrë ato pranë gjykatave dhe janë shumë më pak sesa ato që kanë raportuar në polici dhe nuk kanë arritur të marrin urdhër mbrojtjeje. Pse? Pothuajse në të gjitha bashkitë nën monitorim koordinatorja që ka mekanizmat e referimit sipas bashkive respektive është e mbivendosur me detyra të tjera dhe në shumë prej bashkive ky funksion mbulohet nga specialistët kundër dhunës në familje, nga nëpunësit gjinorë. Ata bëjnë 1 milion punë dhe nuk janë në vendin e punës atëherë kur ndodh dhuna në familje. Institucione si sistemi shëndetësor, mjeku ligjor, prokuroria, përmbarimi, gjykatat në shumicën e bashkive nën monitorim nuk marrin fare pjesë në mbledhjet e grupit teknik ndërdisiplinor.

Kemi folur me punonjësit e barazisë gjinore. Ata nuk kanë fuqi që t’i thërrasin, shpeshherë ndërhyjnë kryetari me telefonata, por kjo ndodh vetëm kur ka projekte të ndonjë

organizate të shoqërisë civile, kur nxitet për t'u bërë aktiviteti. Në momentin që ne kishim ndaluar projektet e shoqërisë civile dhe filluam monitorimin përmes mbështetjes së *UN Woman*, që e falënderojmë përmes projektit të BE-së, monitorimin e gjetëm në një situatë jashtëzakonisht alarmante me zero mbledhje të grupit teknik disiplinuar dhe me zero mbledhje të komitetit drejtues.

Një problem shumë i madh është Bashkia e Tiranës që në të gjithë këta vjet monitorimi nuk e ka mbledhur asnjëherë komitetin drejtues. Kryetari i bashkisë, kryetari i gjykatës, kryetari i prokurorisë të mblidhen dhe të diskutojnë për çështjet e dhunës në familje.

Kjo është e vërtetuar, sepse nuk ka asnjë evidencë që ta tregojë këtë gjë në bashkinë e Tiranës. Po kështu janë edhe bashkitë e tjera, që kanë maksimumi 1 mbledhje.

Buxheti që akordojnë bashkitë, është jashtëzakonisht i vogël, nuk ka lidhje fare me atë që duhet në të vërtetë. Ky buxhet nuk mbulon asnjë fletë material promovues, i cili të paktën duhet të jetë i postuar në qendrat shëndetësore apo te njësitë administrative. E kemi ngritur këtë gjë me bashkitë, rreth 1 mijë fletëpalosje që nuk kushtojnë më shumë se 350 mijë lekë të vjetra mund të bëhen nga bashkitë ose në bashkëpunim me institucionet e shëndetit publik, por as këto nuk bëhen.

Në shumicën e bashkive, koordinatoresha nuk ka kapacitet të ndajë raporte të përmuajshme dhe sistemi *Reval* ishte jashtëzakonisht i ngatërruar, i ndërlikuar, ndërkohë informacioni që merrej ishte pa lidhje me faktin dhe i pakoordinuar me rajonet e policisë. Besoj se tani e di që ka një rregullim të sistemit dhe shpresoj që të jenë përpunuar shifrat. Ne do të vazhdojmë monitorimin, pra do ta shikojmë.

Në shumicën e bashkive, gjykata e rrethit nuk parashikon programe rehabilitimi për dhunuesin, pasi pothuajse shumica e bashkive nuk disponojnë asnjë program të tillë. Ky është në objektivin 3 të Strategjisë për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje në lidhje me punën me dhunuesin. Nuk ka asnjë punë të tillë. Nuk bëhet fjalë për bonuse, për banesa sociale, për viktimat e mbijetuara të dhunës në familje, nuk bëhet fjalë për punësimin e tyre afatgjatë apo për shkëputje të vërtetë nga thonjtë e dhunës në familje. Kemi vënë re se nuk ka asnjë lloj përkujdesjeje për fëmijët e dhunës në familje nga institucionet përkatëse arsimore ku ata janë.

Nuk po zgjatem, se do t'ju sjell dhe me shkrim materialin. Gjërat kryesore pothuajse i thashë. Ajo që dua të theksoj ka lidhje me Strehëzën Kombëtare të Kamzës. Në nëntor përmes programit të mbështetur nga *UN Woman* sollëm një eksperte angleze, e cila menaxhon një qendër për viktimat e dhunës në familje dhe vizitoi Strehëzën Kombëtare dhe

u habit jashtë mase për numrin e dokumenteve që një grua duhej të merrte me vete për t'u strehuar në strehëz. Tani ju i keni lehtësuar, janë 2, por ajo na tha: “Anglia në momentin kur gruaja raporton në polici dhe kjo e fundit ishte organi kryesor, ku ishin aktorët e tjerë që merreshin me rastin, ajo strehohet menjëherë me strehëz pa pyetur, duke e marrë atë me gjithë fëmijët, ashtu siç ka shkuar, pa e kthyer mbrapsht për të mbledhur këto dokumente dhe për ta bërë të aftë për ta çuar në strehës. Ende janë dy dokumente që duhen, të cilat janë: kërkesë-padia, që duhet të ketë bërë gruaja dhe vlerësimi psiko-social. Janë dy gjëra, që mund të bëhen në momentin që gruaja të shpëtojë nga kthetrat e vrasjes në momentin final. Këto gjëra kisha.

Nuk kam ndonjë propozim konkret, por ligjet nuk janë të shkruara në gurë, por janë ligje që ndryshojnë dhe nëse sistemi i koordinimit në këtë format siç është, që një femër që drejton në bashki këtë sistem, ajo duhet të ketë përgjegjësinë kryesore për këtë koordinim, i cili nuk po funksionon. Ne kemi 10-12 vjet që flasim për këtë gjë. Tani duhet të bëjmë diçka ndryshe.

Faleminderit!

Eglantina Gjermani - Faleminderit, zonja Arqimandriti edhe për punën tuaj, edhe për angazhimin dhe për prezantimin, duke na sjellë në vëmendje një sërë problematikash!

Merita Xhafaj - Ndjesë për ndërhyrjen!

Faleminderit, zonja kryetare!

Jam në një linjë me problemin që ngriti zoti Fino. E para, raporti ynë sapo është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore ku janë reflektuar të gjitha komentet. Nëse do të keni edhe ju komente jemi të hapur që t'i marrim edhe ato, t'i reflektojmë dhe t'i ndajmë në të gjitha bashkitë.

Lidhur me analizën që është bërë nga Aleanca e Grave për Barazinë Gjinore, nga zonja Arqimandriti, të gjitha këto analiza bëhen në kuadrin e *Join Work Programm* që firmoset nga agjencitë e UNDP-së me qeverinë shqiptare. Këtu, për çdo raport dhe për çdo analizë që prodhohet qoftë edhe nga organizatat e shoqërisë civile është e nevojshme dhe e domosdoshme të bëhemi pjesë. Minimalisht ta marrim dhe të diskutojmë, të ngrihet zëri dhe të pajtohen problematikat, sepse në të gjitha monitorimet shikoj se askund nuk është logoja e ministrisë. Nëse financimet janë në emër të *Join Work Programm*, për të cilin ka firmosur qeveria shqiptare dhe e përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë ka disa detyrime dypalëshe që janë të parashikuara.

Nga ana tjetër, për Qendrën e Viktimave të Dhunës kam një informacion të detajuar se sa ka strehuar gjatë vitit 2019. Pjesa më e madhe e të strehuarve në qendrën e Kamzës

kanë qenë fëmijë. Krahasuar me numrin e grave, numri i fëmijëve ka qenë dyfish, madje është edhe një e mitur, e cila ka qenë e pashoqëruar.

Eglantina Gjermani - Më falni!

Zonja Xhafaj, ju lutem, se ju kam kërkuar mirëkuptim që në fillim, që secili do të ketë 5 minuta. Juve që në fillim ju dhashë më tepër kohë meqenëse përfaqësoni ministrinë që ka pjesën më të madhe të përgjegjësisë.

Ju lutem, përmbylleni!

Merita Xhafaj – Jo pjesën më të madhe, por është autoriteti përgjegjës dhe është kjo ministri që në emër të qeverisë shqiptare përgatit të gjitha raportet ndërkombëtare, monitoron të gjitha proceset.

Eglantina Gjermani - Dakord.

Faleminderit, që iu përgjigjet edhe zotit Fino, sepse desh më mbyti: “Pse nuk ktheu përgjigje vetë Merita, sepse unë ia bëra asaj pyetjen?”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vazhdojmë me zonjën Aurela Bozo, drejtoreshë e Qendrës për Nismën Ligjore dhe Qytetare.

Zonja Bozo edhe ju jeni e përmbledhur si gjithmonë për sa u përket problematikave të mekanizmit, si dhe na paraqitni sugjerimet konkrete.

Aurela Bozo - Faleminderit për ftesën!

Në fakt disa nga problemet u paraqitën edhe nga koleget e mia, nga Irisi dhe Mirela. Janë probleme që i hasim çdo ditë në punën tonë.

Pavarësisht problematikave dua të ndaj me ju që në të njëjtën kohë duhet të njohim punën që është bërë, se nëse flasim për mbi 4 mijë raste të identifikuar të dhunës në familje në një vit dhe në të njëjtën kohë flasim për rreth 15 raste kur sistemi nuk ka funksionuar me efektivitet, të paktën le të fillojmë nga njohja e asaj pune që gjithë ky mekanizëm i koordinuar i referimit të rasteve ka kryer për të menaxhuar kaq shumë raste të dhunës në marrëdhëniet familjare të identifikuar. Do të desha ta nisja nga njohja e punës së bërë deri tani.

S dyti, dua të falënderoj zonjën Gjermani, Kuvendin për iniciativat, për përmirësimin e kuadrit ligjor, sepse ky përmirësim është mbështetur në praktikën e organizatave të shoqërisë civile dhe më gjerë. Aty ku sistemi nuk ka funksionuar, kjo ka përbërë një bazë të mirë për të përmirësuar legjislacionin ekzistues. E shikoj këtë që konsiderohet si prioritet. Duke vlerësuar faktin që shihet përmirësimi i kuadrit ligjor si prioritet, dua të theksoj se zbatimi i legjislacionit ekzistues ka nevojë të shihet më shumë

sesa si prioritet, sepse ne kemi legjislacion, është konsoliduar, është përmirësuar në vazhdimësi. Vetëm në vitin 2018 kemi ndryshime jashtëzakonisht të rëndësishme në ligjin “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Po veçoj 2 nga 3 aktet nënligjore që janë shumë të rëndësishme, një prej të cilave është vlerësimi i riskut dhe tjetra është lëshimi i urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme.

Nëse është kjo situatë e zbatimit të këtij legjislacioni të përditësuar do të thotë që ne nuk e konsiderojmë sa duhet zbatimin e kuadrit ligjor ekzistues si prioritet. Kam përshtypjen se kërkon më tepër vëmendje sesa ajo që i kemi kushtuar deri tani. Pse e them këtë? Sepse u referohem rasteve konkrete. Një nga rastet e fundit është ai i Durrësit, që është një rast, i cili është trajtuar siç do të trajtohej përpara ndryshimeve të fundit ligjore. Cilat janë arsyet? Ne, por jo vetëm shoqëria civile, me mbështetjen edhe të donatorëve partnerë, agjencitë e UNDP-së, *UN Woman* dhe aktorë të tjerë, nuk arrijmë të kuptojmë se pas kaq trajnimeve që kemi organizuar jemi ende në një situatë të tillë. Mjafton të kontaktoni mekanizmin e koordinuar të referimit në Durrës dhe do të shikoni se është vepruar siç do të veprohej përpara ndryshimeve ligjore, me një kërkesë për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje dhe me disa masa të cilat konsistojnë në urdhërimin e dhunuesit, që të mos cenojë, të mos dhunojë viktimën, të mos ushtrojë dhunë fizike apo dhunë psikologjike, masa që merren vetëm në rastet kur kemi një nivel risku shumë të ulët. Ndërkohë që nuk kemi as kryerjen e vlerësimit të riskut dhe as thirrje të koordinatorës vendore kundër dhunës në familje nga policia për të kryer vlerësimin e riskut. Kjo është e pafalshme mendoj unë si përfaqësuese e shoqërisë civile. Nuk është vetëm ky rast, është një nga rastet e fundit. Mjafton të marrim të dhëna sesi është situata në të gjithë vendin dhe do të shikojmë se në komisariate të caktuara policie apo në drejtori vendore policie nuk është krijuar një praktikë e zbatimit të këtyre ndryshimeve ligjore kaq të rëndësishme. Këto nuk janë ndryshime ligjore krejt të rastësishme, por janë shumë të rëndësishme që kanë synuar ta bëjnë zero atë hapësirën që priste viktima deri sa gjykata t’i lëshonte një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, që do të thotë veçim. Ku është veçimi këtu, me këto masa: “Mos më ngacmo, mos më kontakto?” Normal, që do të ndodhte një situatë e tillë apo siç ndodhi. Normal që do të ndodhë sërish diku tjetër nëse nuk zbatohen këto ndryshime ligjore. Këtu nuk ka asnjë tolerancë. Mendoj, sepse ky është moszbatim i ligjit.

Jam dakord me çështjen që ngriti Mirela. E kemi ngritur edhe më përpara fort, e ngremë përsëri: të bëhen përgjegjës ata që nuk zbatojnë ligjin.

Zëvendësministrja, zonja Kuko tha në fjalën e saj se janë disa raste ku janë marrë masa. Sa raste janë që janë marrë masa për moszbatimin e ligjit “Për masat ndaj dhunës në

marrëdhëniet familjare”?. Kudo që shkojmë në trajnime të ndryshme me policinë, t’u themi dhe ta ndajmë këtë informacion, se përveç kuadrit ligjor, ka dhe një praktikë se në rastet e moszbatimit të legjislacionit personat bëhen përgjegjës dhe merren masa konkrete. Përgjegjshmëria duket se ka mbetur një nga komponentët më të rëndësishëm që duhet të forcohet. Duket se trajnimet nuk po arrijnë të bëjnë punën dhe efektivitetin e duhur. Hajdeni të përdorim edhe këtë moment!

Momenti tjetër është ai që jo vetëm nuk zbatohet ligji, jo vetëm nuk thirret koordinatorja vendore, por policia ashtu sikurse u përmend edhe nga monitorimi vazhdon të punojë më vete, duke e lënë të gjithë mekanizmin e ngritur me aq punë dhe sakrifica jashtë. Ndërkohë në Durrës, në ambientet e gjykatës së rrethit gjyqësor në Durrës ofrojmë shërbim ligjor falas për individët në nevojë, përfshirë viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, falë mbështetjes së PNUD-it. Përmenda vetëm një shërbim. Ndërkohë që ka organizata të tjera që ofrojnë shërbime të tjera. Me çfarë të drejte policia vazhdon me kërkesën për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje duke lënë jashtë totalisht mekanizmin e koordinuar të referimit, për të cilin kemi folur që në VKM-në nr.334? Kjo është e patolerueshme. Këtë e ngriti edhe zonja Farrici që vazhdohet dhe punohet më vete dhe jo në mënyrë të koordinuar. Janë probleme shumë shqetësuese. Kjo për sa i përket zbatimit të legjislacionit.

Në lidhje me ndryshimet ligjore, nëse ka nevojë për ndryshime ligjore, konstatoj nga praktika se duket se është një barrë pak e rëndë për policinë, për SPZ-të që të kryejnë vlerësimin e riskut, por pavarësisht kësaj e para fillon aty, që nuk njoftohet në çdo rast koordinatori vendor siç e parashikon ligji dhe në mungesë të tij të shkojë një punonjëse sociale i bashkisë.

E dyta, vihet re se është komplekse çështja e vlerësimit të riskut. Ne të gjithë e njohim raportin tip që është pjesë e udhëzimit. I kemi parë pyetjet dhe rubrikat pjesë e këtij raporti. Duhet nga kjo pak praktikë që kemi krijuar që koordinatorja vendore kundër dhunës në familje apo punonjësja sociale pranë bashkisë, në mungesë të saj të asistojnë punonjësën e policisë në vlerësimin e riskut. Në gjykimin tim bazuar në përvojën që kemi pasur deri tani kjo është shumë e rëndësishme, sepse aktualisht e kemi “mund”, por kam përshtypjen se pavarësisht kapaciteteve në rast se do t’u themi personave përgjegjës me këtë legjislacionin që keni 1, 2, 3 dhe 4 përgjegjësi ligjore dhe duhet t’i përmbushni ato, le t’i gjejnë mekanizmat, të dalin edhe natën, edhe ditën dhe të kryejnë vlerësimin e riskut në bashkëpunim me policinë, sepse duhet të kryhet së bashku dhe duhet të parashikohet me ligj, si detyrim ligjor.

Çështja tjetër, ajo e masave që përfshihen te UPMM-ja është një çështje shumë e rëndësishme. Kam konstatuar, ju të gjithë e keni parë se çfarë masash përfshin UPMM-ja. Po ta shikojmë me kujdes, veçimi është lënë pak evaziv, sepse e dini se është masa që dhunuesi t'i qëndrojnë larg viktimës te urdhri që lëshon Policia e Shtetit. Bazuar në të gjitha praktikatat e mira që u përmendën, por edhe në qëllimin që pati ky ndryshim ligjor i vitit 2018 që synonte veçimin e dhunuesit nga viktimat, mendoj se ka ardhur momenti të rishikohet ky ndryshim i fundit dhe të parashikohet në masat që Policia e Shtetit merr me urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme edhe veçimi, sepse në të kundërt do të vazhdojmë të kemi raste kur sistemi do të dështojë dhe nuk do të ketë efektivitet.

Për mua, kemi një kuadër ligjor të mirë, që cakton përgjegjësitë konkrete të çdo institucioni, që parashikon jo më për policinë, sepse policia është aktor kyç, por parashikon për secilin institucion jo vetëm të ofrojë atë që ofron, por të mos harrojë për asnjë moment që duhet të koordinojë veprimet me policinë dhe me koordinatorin vendor çdo rast, kemi thënë në VKM, pavarësisht se ku shkon rasti, duhet të shkojë dhe të referohet te policia dhe te koordinatorja vendore. Ndërkohë që nuk na funksionon edhe dyshja polici-koordinatore vendore. Atëherë, çfarë mund të presim nga të gjithë aktorët e tjerë?

Unë mendoj se detyrat janë shumë të qarta në ligj. Kemi një ligj, i cili përcakton shumë qartë se cili është autoriteti kryesor përgjegjës? Cilat janë autoritetet e tjera përgjegjëse? Çfarë detyrash kanë, ta zbatojmë këtë ligj që kemi, natyrisht, edhe ta përmirësojmë me problemet që identifikohen dhe t'i bëjmë përgjegjës ata që nuk e përmbushin detyrimin që ua ngarkon ligji. Natyrisht, kemi edhe raste kur këto ndryshime ligjore janë zbatuar. Nuk po them që nuk kemi raste të zbatimit të ndryshimeve ligjore, por nuk ka asnjë arsye pse të kemi një rast të vetëm, kur nuk kryhet vlerësimi i riskut dhe nuk lëshohet UPMM-ja, ku risku rezulton i lartë gjithmonë.

Kemi pasur disa raste, siç ka qenë komisariati nr. 2. Ne përpiqemi si organizata të shoqërisë civile që të ndajmë praktikatat e mira. Por këtë nuk duhet ta bëjmë vetëm ne, duhet ta bëjnë të gjithë aktorët: edhe ministria, edhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Patjetër që po, duhet të ndajmë edhe praktikatat e mira, edhe rastet e mira. Le ta marrim praktikën e mirë të komisariatit nr. 2, cili ishte SPZ-ja që e zbatoi, le ta çojmë në çdo trajnim që ne bëjmë, dhe ta ndajë atë përvojë nëse nevojitet.

Jam shumë dakord edhe me koleget, të cilët ngritën nevojën e vazhdimit të trajnimeve, mendoj se trajnimet duhet të vazhdojnë. Unë e njoh dhe e vlerësoj punën që bën Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me mbështetjen e agjencive të UN-it dhe të qeverisë suedeze për organizimin e trajnimeve. Do të theksoja që këto trajnime, jo vetëm

duhet të vazhdojnë dhe të jenë të kombinuara, pra me të gjithë anëtarët e mekanizmit të koordinuar të referimit, por ndoshta ka ardhur momenti që duhet të jenë edhe trajnime *on job*: atje ku vjen rasti të kryhet trajnimi së bashku me punonjësin e policisë dhe koordinatoren vendore.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja Bozo!

Vazhdojmë me zonjën Ines Leskaj, e cila, nuk e di, është e pranishme?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën e ka zonja Shtraza, në emër të rrjetit AWEN. Ju lutem, në mënyrë të përmbledhur, pasi e kemi tejkaluar kohën.

Faleminderit!

Irena Shtraza – Përshëndetje të gjithëve!

Do të mundohem të mos bie në përsëritje, pasi një pjesë e mirë e problematikave dhe rekomandimeve u përmendën edhe nga organizatat tona anëtare. Më së shumti do të përmend rekomandimet, por fillimisht dua të bëj një përmbledhje të shkurtër të problematikave që kemi vënë re në terren nga organizatat tona, por që, sado u thanë edhe më parë, mund të thuheshin sërish.

Lidhur me funksionimin e mekanizmave të referimit, sidomos me mekanizmat e rinj, ajo që është vënë re edhe në raportin e përgatitur nga ministria, nga PNUD-i apo edhe nga raporti i Aleancës Gjimore dhe AWEN-it, është mungesa e theksuar e koordinimit dhe nuk mund të thuhet se janë funksionale. Pra, duhet parë me kujdes kur themi se sa efikase janë ose jo. Se mund të themi që ka mekanizma, por, në fakt, duhet të jemi shumë të kujdesshëm kur themi që funksionojnë, pasi në terren është krejt ndryshe.

Për sa i përket rolit të shoqërisë civile në bashkitë ku ka ose jo mekanizma, aty ku ka më shumë prezencë të OJF-ve është parë që mekanizmat janë jofunksionalë dhe ky është një fakt. Por jo gjithmonë funksionon kështu. Ka qenë rasti i Bashkisë së Korçës, ku, pavarësisht se nuk kishte shumë OJF në terren, funksiononte shumë mirë deri vonë, kur pati një lëvizje të koordinatores.

Pra, roli i koordinatorit vendor dhe i anëtarëve të MKR-së është i pazëvendësueshëm, pavarësisht se OJF-të kanë një rol shumë të rëndësishëm dhe i mbajnë gjallë këta mekanizma, nuk janë ato që duhet ta kenë rolin kryesor, në fakt, për t'i mbajtur ata në këmbë.

Shoqëria civile mund të ngrejë edhe kapacitetet, pra t'i fuqizojë aktorët lokalë, por nuk mund të pritët që MKR-ja të mbahet në këmbë vetëm nga organizatat dhe nga shoqëria

civile, rrjedhimisht edhe nga donatorët, sepse ne varemi prej tyre, duke qenë se marrim shumë pak mbështetje nga vetë shteti.

Lidhur me referimin parësor të rasteve, ka një problem, sidomos me policinë, pasi SPZ-të jo gjithmonë presin koordinatorin e dhunës për intervistimin e viktimës dhe vlerësimin e riskut, siç e përmendi edhe zonja Anastasi, por është tejet i rëndësishëm, sepse në terren bëhet shumë problem, sidomos kur lëshohen UPMM-të.

Është e rëndësishme, sipas *feedback*-ut që na ka ardhur nga disa bashki të vogla, që viktimat e dhunës në familje të trajtohen në qytetin ku janë dhe të mos zhvendosen. Ndodh që në pjesë e tyre mund ta ketë gjendjen civile në një bashki tjetër dhe detyrohet kjo e fundit, që nuk e njih fare rastin, ta trajtojë atë rast. Ky është një problem shumë serioz për bashkitë, sidomos për ato të voglat që nuk kanë as mekanizëm funksional referimi.

Banesat sociale dhe bonusi i strehimit mbeten probleme madhore. Ne kemi raste që ju i njihni vetë. Ka qenë e pamundur që me dy-tre vjet asistencë dhe mbështetje nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë, por është e pamundur të gjejmë strehim për viktimat, për shkak se filan bashki nuk ka banesë sociale, sepse nuk ka bonus qiraje dhe viktimat na mbetet ngjitur me derën e familjes së dhunuesit, që e kërcënon vazhdimisht, dhe është në rrezik për jetën gjatë gjithë kohës.

Për sa i përket bashkëpunimit me prokurorinë, nga të gjitha bashkitë me të cilat punojmë, po edhe nga të tjerat më të vogla, na rezulton se mungon pjesëmarrja e prokurorisë në të gjitha tryezat teknike, gjë që bëhet shkas për shtyrjen e tryezave, një problem madhor që pengon ecurinë e punës.

Për sa u përket strehëzave të emergjencës që po hapen, me mbështetjen e ministrisë, nëpër bashki, është një lajm shumë i mirë që po hapen, por pasi hapen, ato mbeten në dorë të fatit, në dorë të shoqërisë civile. Pra, nuk ka një staf 24-orësh që mbulon shërbimin që duhet të ofrohet në këto strehëza. Është bukur të themi se u hapën, por kush do ta bëjë punën?! Stafi i organizatave të shoqërisë civile, që është shumë i vogël, është vënë para faktit që duhet të ofrojë një shërbim, për të cilin nuk ka staf për ta ofruar ose e bën vullnetarisht, thjesht për shkak të misionit të tyre dhe mundohen t'u rrinë grave pranë.

E fundit lidhur me dhunuesit, disa shërbime ekzistojnë, por vazhdojnë të mos përdoren. I kemi në Tiranë dhe në Shkodër. Gjykatat vazhdojnë të mos japin urdhra ose të japin vendime, ku nuk është i detyrueshëm rehabilitimi i tyre. Ndërkohë, një problem kryesor që na ka dalë (po flas shumë shpejt, por do t'i dërgojmë edhe me shkrim) lidhet me dhunuesit me probleme të shëndetit mendor, një kategori që i shpëton shpesh dënimit dhe ajo që ndodh është se ngelen jashtë, nuk dënohen, nuk kanë ku t'i çojnë. Këta janë një rrezik i

vazhdueshëm për viktimën që mbetet e ekspozuar. Nga ana tjetër, edhe viktimat e dhunës në familje, që kanë probleme të shëndetit mendor, janë ato më vulnerable, sepse nuk kemi qendra rehabilitimi ku t'i çojmë. Në *shelters*-at që kemi nuk kemi staf sesi t'i mbështesim me psikiatër, me psikoterapeutë, me personat që mund t'u rrinë afër dhe ata kanë ngelin jashtë sistemit, si, për shembull, rasti i frikshëm i Lezhës. I përmenda këto, pasi nuk u përmendën mjaftueshëm më parë.

Tani do të përmend disa rekomandime. Kam edhe një minutë, apo dy?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Lidhur me shërbimet, në fokus duhet të jenë shërbimet. Nuk mund të presim që shoqëria civile të bëjë gjithçka. Shteti e di se këto janë mundësitë, por ndoshta duhet një buxhetim më i kujdesshëm i strategjisë, sidomos objektivat që kanë të bëjnë me shërbimet specifike dhe me mekanizmat e referimit. Objektivi 3.3, siç e dimë, është ende 64% i pabuxhetuar dhe, rrjedhimisht, nuk mund të realizohet, sepse nuk ka buxhet të mjaftueshëm dhe varemi vetëm nga donatorët. Nuk përfaqësojmë qeverinë, në fakt, por jam e sigurt se bëhet maksimumi nga niveli qendror, por në nivel vendor ka shumë sfida.

Për sa i përket trajnimit, mbetemi të mendimit që trajnimi *on job* i detajuar ose shumë i thelluar është tejet i rëndësishëm, pasi ne na çalon puna tek ai polici që është mizogjen, tek ai gjykatësi që paragjykon viktimën kur jep vendimin. Pra, na çalon puna, sepse njerëzit nuk dinë kush bën çfarë, ndaj duhet me patjetër që të ketë një trajnim të vazhdueshëm, mundësisht edhe të monitorohet me shumë kujdes nga pushteti qendror për të parë a po bëhet siç duhet, a po zbatohet siç duhet.

Një tjetër rekomandim është rritja e vëmendjes për adresimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuar, qoftë dhunues apo viktimë. Hapja e qendrave të emergjencës në çdo bashki është absolutisht e nevojshme që viktimat të mos i spostojmë nga njëra zonë në tjetrën dhe, idealisht, të mos nxjerrim dhunuesin. Ne e dimë këtë gjë që të mos nxjerrim viktimën nga shtëpia, por të nxjerrim dhunuesin. Nuk e di se kur do ta arrijmë këtë gjë, por e mira do të ishte që të mos jetë viktimë që paguan pasojat.

Po, e di që edhe me ndryshimet e reja e keni propozuar dhe është një gjë shumë e mirë, në fakt. Ndoshta edhe me rritjen e dënimit ndaj dhunuesit do të arrijmë që burrat të kenë pak më frikë edhe nga forca e ligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, është e mundur.

Lidhur me ndërgjegjësimin e shërbimeve ekzistuese në komunitet, njerëzit nuk e dinë se çfarë ka, se çfarë ekziston në zonat rurale apo në zonat pak më të largëta, sidomos të jetë në fokus dhuna seksuale. Nisur nga një studim i fundit i rrjetit tonë AWEN në vitin 2018, rezulton se është një problematikë shumë serioze, sidomos mes të rinjve, që i zgjodhëm në studim për të parë pastaj se çfarë ndodh me familjet e reja që krijohen. U vu re se është një problematikë e nevojshme që duhet të adresohet. Ka mungesë ndërgjegjësimi dhe duhet të punohet edhe nëpër shkolla, jo vetëm në gjimnaze, por edhe më herët. E dimë që edukimi seksual mungon nëpër shkolla, por duhet të jetë prioritet edhe për ministrinë; aty nis gjithçka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbarova.

Follow up-i i rasteve sistematikë lidhet me sistemin REVALB, me koordinimin e mirëfilltë, por *follow up*-i është tejet i rëndësishëm. Shpeshherë nuk e dimë se ku është, ngelet hallka në mes. Ndoshta viktima është transferuar, ndërkohë që në sistem nuk figuron fare se ku është dhe çfarë bëhet. Ndoshta me nismën e re të Ministrisë së Drejtësisë mund të kemi ose jo përmirësime. Besoj se do të ketë më shumë të dhëna.

Rekomandim tjetër është fuqizimi ekonomik i viktimave, i cili duhet të jetë prioritet që të mos të bien pre e organizatave, ku kërkojnë lëmoshë për qiranë e radhës, për ushqimin e radhës për fëmijët apo për ndihmën ekonomike.

Rekomandimi i fundit ka të bëjë me medien, se, në fakt, kemi një problem shumë serioz me mënyrën se si raportohet në medie. Ndoshta këtu do të kemi nevojë edhe për mbështetjen e Ministrisë, pasi duhet një bashkëpunim shumë i mirë edhe me Autoritetin e Medies Audiovizive. Media vazhdon të bëjë gafa madhore dhe të jepen emisione në *prime time* që i dëmtojnë vërtet shumë rëndë të gjithë ata. Ne jemi një shoqëri me probleme, por i thellojmë këto probleme. Kështu që puna me mediet duhet të jetë tejet e kujdesshme, ndoshta edhe të penalizohen ato medie që abuzojnë me mënyrën se si i trajtojnë rastet e dhunës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më vjen keq që televizioneve kombëtare, e bëmë edhe vjet, iu tërhoq vëmendja, këtë vit u bë prapë, por, asgjë, vazhdon të ruhet... Nuk e di, ndoshta AMA duhet të bëjë një punë më të mirë në këtë drejtim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ndalem këtu, sepse do t'i dërgojmë edhe me shkrim.

Eglantina Gjermani – Shumë faleminderit!

Me sa duket, unë nuk e menaxhoj mirë kohën.

Ju falënderoj shumë të gjithëve! Të gjitha gjërat që thoni janë shumë të rëndësishme dhe ndihesa shumë në siklet t'jua ndërprisja fjalën, megjithëse duhej respektuar, por fakti që të gjithë kanë edhe angazhime të tjera dhe janë larguar, tregon se e kemi tejkaluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën e ka zonja Ekonomi për një koment.

Milva Ekonomi – Faleminderit, zonja Gjermani!

Edhe unë po e ndiqja me shumë vëmendje këtë gjë, sepse fakti që ne ulemi në këto tryeza dhe diskutojmë, tregon se po ndodh një proces, i cili ka qenë disi i vështirë për t'u filluar vite më parë.

Mekanizmi i koordinimit dhe i referimit është ngritur dhe ka vështirësitë e tij për t'u zbatuar mirë dhe këto tryeza pikërisht këtë gjë sjellin në vëmendje që, ku ka sukses mekanizmi, ku dështon pak dhe ku duhet të ndërhyjmë për ta përmirësuar, por, ndërkohë, ju e thatë dhe unë nuk duhet t'i referohem Sanremos në vetvete, por dua të referoj një gjë shumë të rëndësishme të Sanremo. Besoj se ju kujtohet që atje, ndërmjet prezantuesve, u bë një monolog, ishte më i gjati, që kishte të bënte me dhunën ndaj gruas. Monologun nuk e bëri njëra nga prezantueset, por ai ishte hartuar nga gazetarët që mbështesnin Sanremon dhe mesazhi kryesor që ato dhanë atje ishte: mos pyesni asnjëherë se çfarë kishte veshur një grua kur përdhunohej. Mirëpo kjo gjë më erdhi shumë fort në mendje, sepse e lidh me një situatë tjetër. Unë nuk e di se çfarë betejash bëjmë ne në shkollat tona, madje të njëjtën gjë po ndaja këtu me zonjat Gjermani dhe Spahiu, se na duhet një përfaqësues nga Ministria e Arsimit që ta fusim në grupin tonë të punës dhe duhet të punojmë pafund. Kur punojnë vendet e zhvilluara pa fund për të edukuar brezin e ri, se ajo çështje është edhe si valë, duket sikur një herë merr shumë fuqi ndërgjegjësimi kundër dhunës në familje, një herë tjetër zbrit. Por vëmendjen ndaj kësaj gjëje nuk duhet ta reshtësh asnjëherë.

Kështu që një nga propozimet e mia është që dikush nga Ministria e Arsimit të jetë pjesë dhe ndoshta ne duhet të punojmë, duke pasur edhe donatorët, për të gjetur disa forma inovative për t'i bindur të rinjtë tanë që dhuna në familje dhe dhuna seksuale janë të dënueshme dhe se si dënohen. Sepse ligjet mund t'i bëjmë shumë të mira, ndërkohë një 13-vjeçar ose 17-vjeçar vjen nga një familje e dhunuar, mund ta ketë shumë të fortë modelin, por nuk ka shumë të fortë ligjin në mendje. Prandaj duhet t'i bindim që ekziston një ligj dhe forca e ligjit është më e madhe sesa modeli.

Ndoshta për këtë mund të bëja një thirrje, Tina, që të kemi parasysh se duhet të kemi përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe më shumë vëmendje për brezin e ri.

Mirela Arqimandriti – Të them diçka?

Eglantina Gjermeni – Do t’jua jap fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, ju lutem!

Mirela Arqimandriti – Milva, shumë faleminderit që e ngrite këtë çështje, por unë nuk doja ta diskutoja në këtë tryezë. Ne kemi bërë një video të shkurtër për edukimin ligjor të moshave 14 vjeç deri në 17 vjeç, çfarë i pret ata nëse përndjekin, përdhunojnë e të tjera, të cilën e kemi shpërndarë në disa shkolla, me një kiamet të zi, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, e cila, me thënë të vërtetën, mezi na dha një leje. Kështu që si do ta zgjidhim këtë punë?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Merita, po flas për tjetër gjë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Merita, nuk ka lidhje me ministrinë tuaj tani, mos mendo për çdo gjë që...

E kam fjalën për Ministrinë e Arsimit, i ka dyert e mbyllura për edukimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eglantina Gjermeni – Ju lutem!

Mirela Arqimandriti – Ajo ministri i ka dyert e mbyllura dhe Romina e di këtë, sepse jemi përpjekur shumë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu që faleminderit që e ngrini si çështje dhe, ju lutem, vazhdojeni këtë me Ministrinë e Arsimit!

Eglantina Gjermeni – Patjetër, do ta marrim në konsideratë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën e ka zonja Brunilda Hylviu nga Qendra Shqiptare...

Brunilda Hylviu – Për Popullsinë dhe Zhvillimin.

Eglantina Gjermeni – Po e them unë, sado e kuptoj që mezi po prisnit të merrnit fjalën.

Atëherë, fjala është për ju.

Brunilda Hylviu – Për efekt të kohës.

Eglantina Gjermeni – Por, ju lutem, në mënyrë të përmbledhur!

Brunilda Hylviu – Meqenëse thatë se jemi në fund, gjithsesi, faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dua thjesht të theksoj rolin e shoqërisë civile në fushën e shëndetësisë për të gjithë kontributin e dhënë ndër vite për fuqizimin e kapaciteteve të punonjësve të shëndetësisë,

sidomos të shërbimit parësor, për të dhënë ndihmën e parë për depistimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, të dhunës në familje dhe asaj seksuale. Nga vlerësimet dhe puna jonë e përditshme, ne konstatojmë që mjekët shpeshherë e anashkalojnë pjesën e depistimit të dhunës, por që është një hallkë tejet e rëndësishme dhe e nevojshme për t'u forcuar për të përforcuar mekanizmin e referimit në nivel vendor, le të themi, forcimi i aftësive të mjekëve për të depistuar dhunën në mënyrën e duhur. Ndoshta duhet edhe një rifreskim i protokollit për të depistuar dhunën, sepse mjekët janë një derë e rëndësishme ku gratë takohen: në qendrën shëndetësore... Domethënë, është shumë e rëndësishme pjesa e forcimit të këtij komunikimi, e asistencës dhe shërbimeve të nivelit shëndetësor parësor.

Një moment tjetër, meqenëse ministria është në fazën e rikonstruktimit dhe të forcimit të ndihmës për viktimat e dhunës dhe mbështetjes ndaj tyre, ndoshta fuqizimi dhe mbështetja për organizatat që mbështesin... Ne kemi një qendër shumë të mirë në Jug të Shqipërisë, në Vlorë, qendrën "Aulona", e cila ofron shërbime të integruara të shëndetit riprodhues. Kjo mund të jetë një derë e mirë, ku gratë e dhunuara dhe viktimat e dhunës mund të trokasin, meqenëse kapacitetet aty janë të ngritura prej kohësh (qendra funksionon prej 20 vjetësh si qendër gruaje). Në momentin kur mekanizmi të fuqizohet, shërbime të tjera që ofrohen nga shoqëria civile mund të jenë një hapësirë dhe një derë ku viktimat mund të trokasin. Sigurisht, këtu vullneti është dypalësh, por ne jemi të gatshëm për të dhënë kontributin tonë në këtë drejtim.

Faleminderit!

Eglantina Gjermani – Shumë faleminderit për kontributin dhe për angazhimin tuaj!

Fjalën e ka zonja Elsona Agolli nga UNFPA-ja. Ju lutem, në mënyrë të përmbledhur!

Elsona Agolli – Meqenëse u diskutua prezenca e Ministrisë së Arsimit dhe ndër institucionet që e mbështesin, flasim nga pjesa e donatorëve, jemi partneri kryesor për sa i takon edukatës seksuale.

Për dijeninë tuaj, ndërhyrja në kurrikulë për edukatën seksuale që nga mosha 10 vjeç është një proces i filluar tashmë prej shumë vitesh, ndoshta cilësia e mësimdhënies është njëra nga gjërat që lë për të dëshiruar, por, megjithatë, përpjekja ka qenë madhore, sidomos nga ana e UNFPA-së me financim të fondeve tona dhe pa asnjë lloj kontributi deri diku nga Ministria e Arsimit për mbështetje institucionale për ta shtrirë në të gjithë vendin.

Megjithëse u ngrit edhe çështja e dhunës seksuale, vitin e kaluar është mbështetur të paktën përgatitja e tri manualeve kryesore, të cilat duhet ta fillojnë diseminimin këtë vit në 2020 për sa u takon kapaciteteve të mësuesve, gjithashtu të prindërve që ta pranojnë këtë ndërhyrje edhe në shkolla (është një manual më vete se si punohet me prindin), si dhe për sa i

takon punës në mënyrë të dedikuar me nxënësin, që është pjesë e të gjithë programit për edukatën seksuale.

Nga ju si Kuvend do të kërkonim që investimi i Ministrisë së Arsimit ndaj një ndërhyrjeje, që ndoshta duket si ekstrakurrikulare, të trajtohet me një rëndësi të veçantë jo vetëm nga ana tematike, por edhe nga ana e investimit, sepse kjo, faktikisht, në vendet e zhvilluara është me ligj, nuk është një lëndë kroskurrikulare, por është lëndë e dedikuar, sikurse matematika, fizika dhe historia. Pra, edukata seksuale është lëndë më vete dhe nuk lihet në duart e deri diku të tri profesioneve: mësues i biologjisë, i fizkulturës dhe i edukatës qytetare, të cilët brenda atij orarit “VJK” (veprimtari jashtëkurrikulare) i japin një orë ose dy orë në dispozicion gjatë një viti akademik. Prandaj do të kërkonim mbështetjen tuaj, ndoshta duke e ngritur këtë çështje edhe te Ministria e Arsimit, duke e ftuar, gjithashtu, edhe te prezenca... Pra, herën tjetër të jenë të pranishëm, sepse ne, faktikisht, dhunën seksuale nuk duhet ta trajtojmë si çështje më vete, ajo është dhunë me bazë gjinore, ashtu sikurse duhet të trajtojmë edhe përforcimin e dhunës seksuale në raste emergjence, për të cilat nuk u fol fare sot këtu. Situatat e emergjencave humanitare e nxjerrin më në pah domosdoshmërinë për të investuar më shumë sesa në një dhunë familjare, që edhe në ato raste përshpejtohet ose rritet, ose forcohet.

Këto ishin disa komente të shkurtra, që shpresoj se do t’i trajtojmë të gjithë së bashku në të ardhmen.

Eglantina Gjermeni – Shumë faleminderit, zonja Agolli!

Në fakt, e menduam këtë pjesë të Ministrisë së Arsimit dhe, duke qenë se çështja është kaq komplekse, ndoshta duhet të kishim prezentë zëvendësministrat e të gjitha ministrive që merren me trajtimin e këtyre çështjeve, por edhe kaq dhe nuk po ia dalim dot, pasi të gjithë kanë për të thënë edhe problematikat.

Fjalën e ka kërkuar zonja Spahiu.

Klodiana Spahiu – Faleminderit!

Unë do t’i bie shumë shkurt, se edhe koha ka kaluar.

Dua të theksoj disa pika kryesore. U mundova të mbaj shënime gjatë gjithë kohës, madje do të doja t’i falënderoja të gjithë të ftuarit për referimin, dhe ajo që dua të ndaj me ju në këtë eksperiencë që nga viti 2009 e deri më sot, që unë kam në parlament, është që ne kemi organizuar shumë shpesh tryeza të tilla dhe kemi ngritur problematika të ndryshme, kemi dalë edhe në terren me koleget për të parë se si funksionon sistemi. Mbjaj mend që në vitin 2010 ose në vitin 2011 kemi organizuar një tryezë të tillë në Durrës për të parë se si funksionon mekanizmi i referimit.

Nisur nga të gjitha problematikat që u renditën nga ju, këto janë hallkat e një zinxhiri që, në qoftë se ne nuk i vëmë në punë, nuk i lidhim me njëra-tjetrën, nuk mund të funksionojnë dot kurrë.

Problematikat këtu u përmendën me radhë dhe në fund Elsona ngriti një problem, që mund të jetë më madhori. Nëse ne nuk e fillojmë këtë edukim që në moshë fare të vogël, është e kotë të diskutojmë për më tutje, por këto gjëra do të bëhen paralelisht.

Siç u kërkua këtu sot, të gjitha mendimet e vyera që ju dhatë për ndryshime të rëndësishme ligjore, edhe ato mendoj se shumë shpejt do të jenë të realizuara.

Unë do të doja të theksoja edhe një herë shumë fort që, nëse këtu u ngrit dhe u vu pika mbi “i”, që nuk funksionin, sepse duhet që ai koordinatori vendor të mbajë përgjegjësitë e veta dhe ne duhet të analizojmë disa raste, se ku me të vërtetë ky koordinator nuk i ka mbajtur përgjegjësitë, nuk e ka bërë punën ashtu siç duhet, duhet që edhe ne të qartësohemi se ku do të jetë më i vlefshëm të jetë ky koordinator vendor.

E dimë shumë mirë, ose të paktën nga studimi që ka bërë Mirela, që janë shumë raste të dhunës dhe në fund, kur shohim te mekanizmi i referimit, te rastet e trajtuara, janë shumë pak, nuk është as 1/10-a e rasteve. Si ka mundësi që gjithë këto raste që raportohen nuk trajtohen? Si ka mundësi që nuk është ky mekanizmi i referimit në të cilin xhirojnë këto raste?

Unë si anëtare e nënkomisionit, së bashku me kryetaren, mendoj të dalim edhe në terren, por besoj se terreni nuk do të jetë vetëm me përfaqësuesit e bashkisë, por duhet të jetë domosdoshmërisht i gjithë mekanizmi dhe në qoftë se ne insistojmë dhe themi që nuk funksion komiteti drejtues në çdo rajon, atëherë hajde, ne si funksion monitorues, siç e ka parlamenti, të insistojmë, duke filluar nga ky komitet drejtues, që ta fillojë punën e vet, ta bëjë siç duhet, sepse nëse funksionon siç duhet komiteti drejtues, besoj se edhe hallkat që varen prej tyre do të funksionojnë siç duhet.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, Klodi!

Udhëroni, zonja zëvendësministre!

Romina Kuko – Kam dy gjëra shumë shkurt:

Problemi i parë lidhet me detyrimet e policisë dhe rolin e policisë. SPZ-të kanë me ligj 50 detyra për të kryer në terren. Pra, ligji ngarkon SPZ-të që të merren me kontrollin e territorit, dhunën në familje, çështjet që kanë të bëjnë në ndihmë të bashkive, me një fjalë një konglomerat detyrash, të cilat u lënë atyre një hapësirë tejet të kufizuar për t’u marrë në mënyrë të qenësishme me pjesën e dhunës në familje.

Prandaj unë thashë se duhet të ketë një menaxher rasti, në mënyrë që SPZ-ja të jetë në shërbim dhe të mos jetë përgjegjëse se nuk e bën dot këtë gjë.

Problemi i dytë është se ne kemi trajnuar policinë deri më sot, por kontrollori i policisë nuk mund të jetë vetë policia dhe është e natyrshme që një organizatë të ketë një vlerësim për veten pak më pozitiv se sa ç'ë kemi në realitet. Kontrollori i punës së policisë është SHÇBA-ja, Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave.

Duke përfituar nga rasti, meqenëse kemi këtu edhe partnerët, ne mund të bëjmë edhe trajnime të SHÇBA-së. Pra, kjo është një strukturë, e cila është prezente në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe të trajnojnë këtë strukturë, e cila më pas ka mundësi për të bërë monitorimin e punës së policisë, standardet e të tjera. SHÇBA-ja ka aftësi dhe detyrim ligjor të ndërmarrë edhe ndëshkimin e duhur në rast se detyrat nuk plotësohen ashtu siç duhet.

Lidhur me pjesën e shkollave, ju, zonja Milva, keni shumë të drejtë që shkollat duhet të jenë të përfshira në këtë proces.

Ne kemi oficerët e sigurisë në shkolla, pjesë e projektit që kemi një vit që jemi duke e zbatuar. Pasnesër do të bëjmë një takim me të 150 oficerët e sigurisë së shkollave në të gjithë Republikën e Shqipërisë. Ata do të mbledhen në Tiranë për të bërë një analizë për vitin 2019. Ky është moment shumë i mirë që ne të bëjmë një bashkëbisedim edhe me ta, për t'i parë edhe si agjentët e parë, sidomos në pjesën e gjimnazit, për të parë shenjat e para të dhunës në familje apo për një hartëzim brenda shkollës rreth të rinjve, të cilët kanë një probabilitet për të qenë në situatë dhune.

Megjithatë ky është një diskutim që ne mund ta hapim këtu dhe pastaj e vazhdojmë në një moment tjetër.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Unë s'kam ç'të them se i thatë të gjitha. Ne sot ishim këtu si dy komisione për të dëgjuar dhe për të marrë një informacion lidhur me këtë studim, raport përfundimtar që është bërë nga ministria dhe nga partnerët ndërkombëtarë.

Zonja Merita e tha shumë mirë, që të gjitha këto që u thanë këtu, mirë është t'i përmbledhim për ta bërë raportin më të plotë dhe për të dhënë zgjidhje për të ardhmen.

Pra, gjithë kjo kohë që harxhuam, 2 orë e ca, duhet që ne si parlamentarë bashkë me ju si ministri e linjës, duhet të japim disa zgjidhje konkrete.

Këtë që sapo tha zëvendësministrja, kush do të jetë menaxheri i rasteve? Do ta lëmë në bashki? Do ta lëmë në polici? Këtë gjë ju si ministri, por edhe ne si dy nënkomisione

duhet ta ndajmë përfundimisht dhe të bëjmë një trajnim tamam, që të merret me këto raste dhe duke u marrë me këto raste, se nuk është thjesht që t'i kontrollojmë, t'i vëmë në lëvizje që të punojnë.

Unë shikoj që ligjet i kemi, aktet nënligjore i kemi, trajnime bëni plot, por problemi është se nuk zbatohen dhe nuk ecin ashtu si duhet. Pra, kryesorja është se si do ta zgjidhim. Ne do t'u vëmë detyra edhe bashkive, detyra dhe funksione te deleguara, por pse jo edhe me urdhër për të thënë që x% të buxhetit ti do ta kesh për këtë gjë, se me sa pash në këtë material, shumat janë shumë qesharake. Kjo do të thotë se çdo bashki duhet të ketë buxhetin e vet që t'i trajtojë këta njerëz, përveç asaj që bëjnë OJF-të dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë, që ne i falënderojmë, apo edhe ju si ministri, por duhet që vetë bashkitë të interesohen.

Ne mund ta bëjmë si të doni ju, me vendim qeverie apo me ligj, se ne prandaj e bëjmë këtë bashkëbisedim, që në fund të vendosim të bëjmë disa gjëra, të cilat të funksionojnë nesër tek të 61 bashkitë.

Po të bëjmë të funksionojnë disa gjëra, për shembull, menaxherin e rasteve, funksioni të jetë i deleguar, fondet buxhetore të jenë x me përqindje në kuptimin që asnjë këshill bashkie të mos tolerojë për këtë pjesë të buxhetit që këshilli bashkiak miraton për çdo bashki në fillimit.

Unë do të thosha se këto tri gjëra mund të bëjmë ne si nënkomision i pushtetit vendor, pra t'u japim mendime, t'i shkruajmë...

Ju si nënkomision mund të na jepni edhe mendime të tjera që në përfundim mendoj se duhet të mblidhemi përsëri të dy nënkomisionet për të rakorduar përfundimisht dy-tri gjëra konkrete që ne mund të bëjmë, ose në proces ligjor, ose në proces të linjës, që t'i japim ministrisë së linjës të na bëjë disa udhëzime apo vendime qeverie, të cilat ne mund t'i shkojmë prapë këtu.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zoti Fino!

Aurela Bozo – Ju kërkoi ndjesë që e kërkova fjalën në mbyllje, por natyrshëm më erdhi një reflektim.

Kemi punuar shumë ndër vite të tëra, që nga viti 2007, që ka hyrë në fuqi ligji dhe deri më tani, për të përmirësuar kuadrin ligjor, kemi punuar për gjithë këto vite për të ngritur strukturat dhe i kemi forcuar ato në atë nivel ku i kemi sjellë aktualisht dhe për të gjithë ne që jemi ulur këtu është shumë e qartë se çfarë bën koordinatori vendor kundër dhunës në familje, identifikon nevojat e rastit, i ndan me të gjithë anëtarët e ekipit dhe menaxhon rastin. Kështu

që mendoj se gjithë vëmendja duhet të jetë te zbatimi i legjislacionit ekzistues, fuqizimi i burimeve njerëzore, financiare dhe zbatimi i këtij kuadri ligjor.

Faleminderit!

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zonja Bozo!

Bashkim Fino – Unë tërhiqem, s'ka problem, se unë jam mediokër në këtë drejtim. Unë thjesht doja që këto që bëjmë të zbatohen prej bashkive që sot nuk po punojnë. Me sa po del në pah, bashkitë nuk janë në nivelin e duhur. Unë tërhiqem, nëse ju thoni se ligjet janë, atëherë në rregull, le të bëjmë ligje të mira dhe asgjë nuk zbatohet. Unë them se si do ta zbatojmë në një bashki konkrete.

Aurela Bozo – Më duket se jemi duke thënë të njëjtën gjë, zoti Fino.

Reagimi im ishte në lidhje me një vëmendje që po i kushtohet një termi, që quhet “menaxher rasti”.

Reagimi im kishte të bënte vetëm me faktin se nuk ka nevojë për vëmendje për një emërtim të ri, se u diskutua gjatë kjo çështje, por ka nevojë për zbatimin e kuadrit ligjor ekzistues. Aty i kemi edhe koordinatoren vendor, edhe policinë, zemrën e mekanizmit. Le të punojnë së bashku dhe të koordinojnë me të gjithë të tjerët.

Eglantina Gjermani - Faleminderit!

Në fakt, edhe kjo seancë dëgjimore, edhe seancat e tjera që kemi organizuar së bashku, janë në funksion të kontrollit parlamentar, të cilin parlamenti shqiptar e ka forcuar dhe vazhdon ta japë si kontribut në mënyrë të vazhdueshme. Edhe ky takim, edhe vazhdimësitë, letrat, takimet, vizitat në terren për të parë mekanizmin e dhunës, për të takuar të gjithë aktorët, janë pjesë funksionale e rolit të parlamentit.

Doja t'ju falënderoja të gjithëve, zonja zëvendësministre, zonja Xhafaj, zonja Aliaj, të gjithë ju, përfaqësuesit e shoqërisë civile, të shoqatave vendore për angazhimin, për kontributin që jepni, në mënyrë të veçantë organizatat e kombeve të bashkuara, të cilat nuk e patën të gjitha mundësinë të flisnin. Ju kërkoi ndjesë për këtë, por e vlerësoj jashtëzakonisht kontributin dhe angazhimin tuaj për ngritjen e mekanizmit të dhunës edhe ndihmën që u keni dhënë bashkive, trajnimet dhe të gjithë në bashkëpunim me ministrinë.

Mendoj se, pavarësisht se u zgjatëm, gjërat që thamë janë shumë të rëndësishme.

Ashtu siç tha edhe zoti Fino, ne do të mblidhemi si dy nënkomisione për të vijuar punën edhe për të qenë në kontakt më tej për hapat që do të ndërmarrim.

Faleminderit të gjithëve!

Faleminderit të gjithë kolegëve deputetë që ishin të pranishëm!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar

**Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili**

Sekretare e komisionit